



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Stomatologji”
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Asoc. Teuta Pustina Krasniqi

Dr. Alketa Qafmolla

Dhjetor / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave (PI) në “Stomatologji”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Stomatologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Stomatologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 197, datë 07.04.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 385, datë.06.09.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim BA Nr. 88, datë 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite / 10 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	35 PAE dhe 19 PAK
18	Numri i studentëve:	2017-2018 - 56 studentë; 2018-2019 - 60 studentë; 2019-2020 - 122 studentë; 2020-2021 – 82 studentë; 2021-2022 - 108 studentë.



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Albanian University" (AU) ish shkolla e lartë universitare jopublike "Ufo dental" është licensuar me VKM Nr. 197, datë 10.04.2004. Ka ndryshuar statusin dhe është riorganizuar sipas VKM Nr.597, datë 28.5.2009 për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat "UFO University, dhe gjithashtu mbështetur në VKM Nr. 603, datë 24.8.2011, për ndryshimin e emrit të universitetit privat nga "UFO University" në "Albanian University". Riorganizimi institucional është mbështetur në urdhrin e MAS Nr.52, datë 05.02.2016. Albanian University është akredituar për herë të parë nga Bordi i Akreditimit me vendim Nr. 90, datë 20.10.2017 "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat "Albanian University. Riakreditimi i dytë bazohet në Vendimin e BA-së, Nr. 01, date 24.01.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat "Albanian University", me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite. Albanian University përbëhet nga 3 Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;

Njësia bazë që e ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Stomatologji" është Departamenti i Stomatologjisë që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Ky program studimi është hapur fillimisht sipas VKM Nr. 197, datë 10.04.2004, ku në fund të studimeve studenti merrte diplomën si "Mjek stomatolog i përgjithshëm", me kohëzgjatje 4 vite akademike. Sipas Urdhërit të MASH Nr. 197, datë 07.04.2010, ky program studimi u riorganizua nga program studimi i ciklit të dytë në "Stomatologji" me kohëzgjatje 4 vite akademike, në program studimi i integruar i ciklit të dytë në "Stomatologji" me kohëzgjatje 5 vite akademike dhe 300 kredite. Programi i studimit është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit, VBA Nr. 88, datë 21.09.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me vlefshmëri deri në 30.09.2022.




SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 88, datë 21.09.2017 janë:

1. Institucioni duhet, në vijim, te garantojë vazhdimësinë e stafit të kualifikuar, pasi personeli akademik i kategorisë "Profesor" është afër moshës së pensionit ose e ka mbushur atë;
2. Duhet punuar më shumë për marrëveshje të reja bilaterale që parashikojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. GVJ duke iu referuar dokumentacionit në dosjen e vetvlerësimit dhe vizitës në institucion konstaton se Rekomandimi i dhënë në akreditimin e kaluar me sa vijon "Institucioni duhet, në vijim, te garantojë vazhdimësinë e stafit të kualifikuar, pasi personeli akademik i kategorisë "Profesor" është afër moshës së pensionit ose e ka mbushur atë", **plotësohet kryesisht.** Në vizitën dyditore, u kërkua dokumentacioni shtesë dhe u ngarkua në ASCAL ku ndër të tjera janë edhe 42 CV. Nga 42 mësimdhënës sa janë të deklaruar me CV, 3 janë me tejkalim moshe, një pjesë janë staf që nuk i përkasin fushës së stomatologjisë, dhe janë të fushave profesionale, si Juridik, Informatikë, Agrikulturë, Business English, Histori.
2. GVJ duke iu referuar dokumentacionit në dosjen e vetvlerësimit dhe vizitës në institucion konstaton se Rekomandimi i dytë "Duhet punuar më shumë për marrëveshje të reja bilaterale që parashikojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve;" po ashtu **plotësohet kryesisht.** Marrëveshjet e reja bilaterale janë të evidentuara përmes dokumentacionit të pasqyruar në Evidencë 1.20.a., 1.20.b., 1.20.c., 1.21. dhe 1.22. ku shihen marrëveshje të nënshkruara ndërmjet Albanian University dhe Institucioneve të tjera si Universiteti i Ferrarës, ISHP, Universiteti i Birunit, dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare pranë Universitetit të Shkencave Mjekësore. Mirëpo, shkëmbimi i stafit dhe i studentëve, sërish është i pamjaftueshëm.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Stomatologji” të ofruar nga Departamenti i Stomatologjisë pranë Universitetit Privat “Albanian University”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL. Edhe pse, në RVB janë vendosur të dhënat sipas rendit dhe pikave të përpilimit, në përbërje të këtij raporti janë disa të dhëna josubstanciale. Duke e analizuar RVB, lexuesi mund të ketë përshtypjen se dokumenti nuk është kontrolluar në tërësi për një harmonizim të tij. Në web faqe të Universitetit në pjesët ku përshkruhen lëndët përbërëse të Programit Msc e Integruar në Stomatologji ka mangësi, pasi lëndët janë të vendosura për vit akademik, dhe nuk janë të ndara për secilin semester, nuk figuron lista e stafit akademik në veçanti dhe po ashtu në ëeb faqe CV e stafit akademik nuk janë të publikuara, dhe për më shumë mungojnë të dhënat për kërkime shkencore. Në të ardhmen, duhet kushtuar më shumë rëndësi përpilimit të RVB dhe të dhënave në ëeb faqe, pasi që këtu pasqyrohet një pjesë përbërëse e rëndësishme e institucionit, me të cilën sigurohet cilësia që e ofron një Universitet.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga AU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Teuta Pustina Krasniqi dhe Dr. Alketa Qafmolla. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. Vizita 2 ditore në AU, u realizua gjatë datave 23-24/06/2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit të Stomatologjisë dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, me sekretarinë mësimore etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.



Universiteti Privat "Albanian University", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.12.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/54 Prot, datë 07.12.2022. Universiteti Privat "Albanian University", përcjell në ASCAL më datë 14.12.2022, me anë të shkresës me Nr. 680/12 Prot., datë 14.12.2022, "Kthim përgjigje shkresës me Nr. 24/54 Prot, datë 07.12.2022". Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për Komentin që i përket plotësimit të rekomandimeve nga akreditimi paraardhës (RVJ, fq.4):

GVJ shqyrtoi sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit të bërë duke u bazuar në të dhënat në dispozicion, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm vlerëson se një pjesë e stafit nuk i përkasin fushës së stomatologjisë konkretisht: Elona Limaj i takon fushës së Linguistikës/ *Evidenca 1.13*; Eliana Paço ka të përfunduar Fakultetin e Historisë-Filologjisë/ Gjuhë, letërsi dhe Civilizimi Italian, *Vizita dy ditore dhe dokumentacioni shtesë, Nr. 20. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*

2. Për Komentin që i përket standardit I.6, kriteri 1:


GVJ rithekson se linku rreth të dhënave të Revistës OPTIME, gjatë procesit të vlerësimit (kur është shqyrtuar DVV), nuk ka funksionuar dhe vazhdimisht paraqitej faqja *Page Not Found*. Sidoqoftë, tani linku është aktiv dhe kjo nuk paraqet ndonjë pengesë. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

3. Për Komentin që i përket standardit II.1, kriteri 7:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar se Temës së Diplomës duhet ti kushtohet më shumë impakt, gjerësisht të rritet numri i ECTS-ve, nga 10 ECTS në 15 ECTS. Në llogaritjen e 3-5% të totalit të 300 krediteve rezulton se 3% paraqet kufirin e poshtëm minimal nga ky total. Me qëllim të rritjes së cilësisë, mendojmë dhe rekomandojmë se studentit duhet ti sigurohet hapësirë e mjaftueshme kohore për përgatitje të temës së diplomës, sidomos kur bëhet fjalë për fushat humane. Duke e pasur parasysh se Departamenti i Stomatologjisë do të fillojë programin e përbashkët me Universitetin e Ferrarës me 360 ECTS, kjo paraqet një arsye edhe më të fortë që të rritet numri i ECTS për Temë Diplome. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

4. Për Komentin që i përket standardit II.7, kriteri 4:

GVJ përgëzon Departamentin e Stomatologjisë për ndërkombëtarizimin e programit të përbashkët në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, program ky i cili do të ofrojë 360 ECTS, gjegjësisht



6 vite studimi. Megjithatë, bazuar në të dhënat në Evidencën R.2.a., shihet një numër i lartë i bashkëpunimeve me Institucione brenda dhe jashtë vendit, me sa vijon: *Spitali Universitar i Tiranës, Instituti i Shëndetit Publik, Biruni University, Universita' degli studi di Ferrar, Altinbas University, Medical Team SRL, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Meditarrenaeen and Middle East University, Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, Spitali Salus, Fondazione "Buzëqeshja e Mësuesit", U.O. Maxillo Faciale Ospedato Belcolle AUSL Viterbo, Shoqata për Integrim Të Pensionistëve të Shqipërisë, Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit, Akademia IVODENT, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Universita Degli Studi di Roma "Tor Vergata", Universidade Fernando Pessoa, Universiteti I Tiranës, Sigmund Freud University, UMF "Grigore T.Pop", Facultatea de Medicina, Dentaria – Romania, Universita degli studi dell Aquila, etj.* Andaj, GVJ i qëndron rekomandimit, që MoU e nënshkruara të funksionalizohen dhe të konkretizohen, gjithmonë në synim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, me studentin në qendër. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar

“MASTER I SHKENCAVE NË STOMATOLOGJI”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	GVJ konstaton se Programi i Integruar Master i Shkencave në “Stomatologji” i ofruar nga Albanian University, ka qëllim të krijojë specialistë dhe profesionistë të rinj të edukuar me standarde evropiane në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë, prandaj, programi i IAL i kontribon pozitivisht shëndetësisë dhe interesave kombëtare. Ky program studimi është hapur fillimisht sipas VKM Nr. 197, datë 10.04.2004, ku në fund të studimeve studenti merte diplomën si “Mjek stomatolog i përgjithshëm”, me kohëzgjatje 4 vite akademike. Sipas Urdhërit të MASH Nr. 197, datë 07.04.2010, ky program studimi u riorganizua nga program

P. P. P.

P. P. P.

	studimi i ciklit të dytë në “Stomatologji” me kohëzgjatje 4 vite akademike, në program studimi i integruar i ciklit të dytë në “Stomatologji” me kohëzgjatje 5 vite akademike dhe 300 kredite. Kjo diplomë iu shërben të rinjve shqiptarë të punësohen si brenda dhe jashtë vendit.			
Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Departamenti i Stomatologjisë, së Fakultetit të Shkencave Mjekësore, është njësi përgjegjëse e ofrimit të programit të studimit në bashkëpunim me strukturat mbështetëse të AU, dhe si i tillë bazuar në RVB ka si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike kulturore dhe kombëtare.			
Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar (Evidenca 1.4, kreu II neni 4), ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit. Ai është hartuar sipas nevojave të tregut të punës dhe në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Programi ka për bazë të formojë kuadrot e reja profesionale, në fushën e stomatologjisë. Ky program ka në bazë kërkimin shkencor dhe krijon baza të qëndrueshme njohurish për të vazhduar me pas studimet e ciklit të tretë.			
Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi është hartuar dhe plotëson kërkesat ligjore dhe të akteve nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë në Shqipëri. Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Stomatologji është hartuar ndër vite duke patur në vëmendje dhe prioritet nxitjen dhe zhvillimin ekonomik dhe social kombëtar, që është në përputhje të plotë me strategjinë e Institucionit. (Evidenca 1.4, kreu II neni 4),			
Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;	Duke shqyrtuar DVV (Evidencë 1.6), GVJ vlerëson se programi i ofruar nga FSHM / AU “Master i Shkencave” në Stomatologji, nëpërmjet gërshetimit të lëndëve bazë dhe karakterizuese, të formimit paraklinik dhe atij klinik, krijon një themel të qëndrueshëm mbi të cilin studentët mund të bazohen plotësisht si dhe të avancojnë formimin e tyre në studime të thelluara të ciklit të tretë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

P. P. P.

P. P. P.

Standardi I.2	
Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional. Duke u bazuar në (Evidencë 1.5.Strategjia 2017-2022), parashikohen dhe orientohen direktivat e ofrimit dhe të ecurisë në terma afatmesëm dhe afatgjatë të programeve të studimit, konform të cilave ofrohet dhe programi i studimit Master i Shkencave në Stomatologji. Albanian University synon të ofrojë arësim cilësor dhe trajnim profesional në nivelin evropian.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrjnë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Institucioni vepron në përputhje të plotë me statutin, rregulloren e fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit për mbarëvajtjen e procesit akademik. Programi i studimit është në përputhje dhe në zbatim të neneve 2 dhe 3 të Statutit. Stauti i AU është përpiluar në bazë të nenit 102 të Kushtetutës të nenit 33, të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores e Përgjithshme të Albanian University, (Evidencë 1.2) ku përcaktohen qartë drejtimit dhe prioritetet akademike mbi të cilat zhvillon aktivitetin e saj Institucioni I Arsimit të Lartë privat Albanian University.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (KSHK) dhe zhvillohet në përputhje me drejtimit akademike të institucionit. Ky program studimi, ofrohet me kohë të plotë dhe përfshin krahas formimit teorik bashkëkohor edhe pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore, të cilat kryhen në Institucionin që realizon programin, por edhe në Institucionet mbështetëse me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, sipas procedurave dhe protokolleve mjekësore të aprovuara dhe që janë në zbatim në veprimtarinë e tyre. Për këtë qëllim janë ngarkuar udhëheqës praktikë dhe tutorë, që janë specialistë në Stomatologji.
Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të	Programi i studimit synon të përgatisë stomatologë të aftë e të mirëinformuar në fushën e Stomatologjisë, që të jenë të gatshëm profesionalisht për të përballuar kërkesat e tregut të punës në shërbimin stomatologjik. Ky program studimi është hartuar dhe

zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	GVJ konfirmon se objektivat e programit për formimin e studentëve përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore dhe aftësitë e kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Programi ka si synim kryesor formimin e stomatologëve si profesionistë të rëndësishëm në sistemin shëndetësor si dhe industrinë, kontrollin dhe tregun e stomatologjisë. Të diplomuarit pajisen me bazën shkencore, teorike dhe praktike si dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale (p.sh. komunikim) të nevojshme për të ushtruar profesionin e stomatologut në të gjitha sferat relevante, ashtu siç edhe e kërkon tregu i punës. (Evidencë 1.6); (Evidencë 1.7).
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të	Komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës, ishin disa nga të dhënat të cilat i morëm gjatë takimit. U diskutua rreth përshtatjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit që u tha se bëhet në mënyrë periodike nga departamenti, mbi bazën e analizave të herëpashershme që institucioni ndërmerr dhe realizon mbi tregun e punës, kontakte të vazhdueshme që ai ka me personat e interesit si mjekë, stomatologë apo institucione të këtij profili. Zyra e Alumnit dhe Karrierës synon lehtësimin e

Publika

Publika

<p>studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>lidhjeve midis karrierës akademike dhe mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar në Albanian University dhe promovimin e tyre në institucionet, klinikat, laboratorët apo kompanitë, të cilat janë të interesuara për punëmarrës. Që prej vitit 2018 AU është pjesë e projektit GRADUA. (Evidencë 1.8).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënies garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përfitimi i dijes, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut arrihet përmes qasjes e kombinimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke i adoptuar, dhe duke i bërë të mundshme për studentët që të identifikojnë dhe përdorin përvojën e tyre, njohuritë që më së miri i avancojnë ata në procesin mësimor dhe i bëjnë të gatshëm për punësim.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi është i organizuar në lëndë të cilat korrespondojnë me kreditet formuese në bazë të Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Departamenti i Stomatologjisë realizon leksione të hapura të herepashershme me lektore të huaj, ka të ftuar pedagoge të huaj në programin e stomatologjisë, promovon bashkëpunime të shumta me personalitete të profileve të ndryshme të fushës dhe ka studente të huaj, të cilët ndjekin studimet në programin e stomatologjisë.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi i studimit hartohet në përputhje me direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluar dhe me sistemin e Bolonjës. Programi i studimit Master i Shkencave në Stomatologji është një program me një kurrikulë të konsoliduar prej shumë vitesh e hartuar e bazuar në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e</p>	<p>Plani mësimor i programit “Master i Shkencave” në Stomatologji, ofruar nga IAL “Albanian University”, ofron praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit. Gjatë vizitës së GVJ në sallat stomatologjike, u vërejt se ato ishin</p>

P. P. P.

P. P. P.

programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	të pajisura me mjete adekuate për zhvillimin e mësimit praktik, që njëkohësisht i përgatit studentët për aftësi profesionale superiore. (Evidencë 1.6)								
Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Bazuar në RVB dhe në dokumentet e ngarkuara në ASCAL, departamenti organizon në mënyrë të vazhdueshme aktivitete të ndryshme si leksione të hapura me lektorë të huaj, trajnime, punëtori e simpoziume (Evidencë- 1.11.a) dhe se departamenti i Stomatologjisë ka mirëpritur një numër studentësh të huaj të cilët ndjekin programin e stomatologjisë. (Evidencë-1.1 1.b). Në Evidencë-1.1 1.b, janë të shënuara marrëveshjet që janë bërë nga ana e Universitetit me universitete të tjera me qëllim shkëmbimi të studentëve, dhe janë të evidentuara mobilitetet konkrete ndëruniversitare. Programi i integruar i stomatologjisë ofrohet në gjuhën shqipe sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015. AU ne bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës dhe universitete të tjera italiane, më 27/11/2019 ka aplikuar në MAS programin e stomatologjisë ne gjuhë të huaj. (Evidencë- 1.10).								
Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Sa i përket arkivimit të dokumentacionit me të cilin dëshmohet rreth aktivitetetve të zhvilluara në gjuhën angleze, sipas RVB është dhënë linku, ku faqja nuk hapet / Page Not Found/ https://albanianuniversity.edu.al/en/department-ofdentistry/								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4

Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë	GVJ konstaton se institucioni ka përvojë të gjatë 18 vjecare në ofrimin e programeve të studimit në fushën e Stomatologjisë. Bazuar në vizitën dy ditore dhe në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin ASCAL, institucioni i përmbush kapacitetet dhe burimet e duhura ne fushën akademike. Burimet financiare për programin e studimit jane ato që lidhen me tarifat e shkollimit të

P. P. P.

P. P. P.

	<p>studentëve. Rreth 1/3 e këtyre burimeve shpenzohet për qirane e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.).</p> <p>Referuar dokumentit (Stomatologji-Aneks Permbledhje Tabela,tab nr.1) për vitin akademik 2021 – 2022, Fakulteti i Shkencave Mjeksore ka në përbërje 198 staf akademik gjithsej, nga të cilët 100 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 98 staf akademik me kontratë (PAK). Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjeksore në AU. GVJ konstaton se IAL e ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën e stomatologjisë për ofrimin programit në fjalë.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Msc i integruar në “Stomatologji” është program studimi i ciklit të dytë, që i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave mjekësore, me drejtim specifik në stomatologji. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Shkencave Mjekësore).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit “Masteri Shkencave në Stomatologji” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Prioritet i departamentit mbetet të jetë zgjerimi i aktivitetit kërkimor dhe shkencor nëpërmjet aplikimeve në projekte te ndryshme kombëtare ose ndërkombëtare.</p>

P. P. P.

P. P. P.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë mbi hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit janë të përcaktuara në Statutin e IAL. Ato janë të ndara dhe të harmonizuara midis strukturave organizative, organeve dhe autoriteteve drejtuese. IAL vlerëson performancën e programit të studimit për çdo vit, në të cilën përfshin treguesë të performancës së mësimdhënies, hulumtimit shkencor dhe përgjigjen ndaj shoqërisë, mbështetur në raportin vjetor. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. (Evidencë- 1.1); (Evidencë- 1.2).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Marrëveshjet e Bashkëpunimit janë të evidentuara përmes dokumentacionit të pasqyruar në (Evidencë 1.20.a. 1.20.b., 1.20.c., 1.21. dhe 1.22), ku shihen marrëveshje të nënshkruara ndërmjet Albanian University dhe Institucioneve të tjera si Universiteti i Ferrarës, ISHP, Universiteti i Birunit, dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare pranë Universitetit të Shkencave Mjekësore, si i pari dhe i vetmi institucion publik në vend.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave</p>	<p>GVJ konstaton se duke u bazuar në bashkëpunimin e ngushtë mes Klinikës Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj”; Universitetin e Ferrares, Itali, (Evidencë R.2.a), me Universitetin e Napolit, në kuadër të marrëveshjes MUNA /(Erasmus+ me UniNapolin), ne Evidencen R.2.a., ky program studimi arrin të përmbushet me sukses, si nga ana teorike ashtu edhe praktike.</p>

P. P. P.

P. P. P.

profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.									
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Referuar RVB-së, Praktika në pacientë brenda planit mësimor përmbushet pranë Klinikës Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj. Për të kryer praktikën profesionale, AU bashkëpunon ngushtë me Poliklinikën Dentare UFO, si pjesë e brandit UFO SHPK, si dhe Shkollën e Specializimeve Afatgjata në Albanian University.								
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Marrëveshja e nënshkruar me Institutin e Shëndetit Publik, është një tjetër potencial shfrytëzimi në funksion të kërkimit shkencor. Lidhur me bashkëpunimin me institucione homologe me qëllim të realizimit të kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik AU ka nënshkruar MoU me institucione prestigjioze si Universiteti i Ferrarës, Itali, (Evidencë 1.20.a) Universiteti Federico II te Napolit, Itali (Evidencë R.2.a) apo Institutin e Shëndetit Publik, (Evidencë 1.20.b), të cilat ndihmojnë në përmbushjen e objektivave me qëllim të ngritjes së cilësisë në programin e studimit. Që nga viti 2017, Albanian University është bërë pjesë aktive e Programeve Erasmus+, nëpërmjet të cilave është mundësuar mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve.								
Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Në raportin e fundit periodik analitik të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të marrëveshjeve për vitin akademik 2021/2022, të dokumentuara në Evidencë 1.23 shihen mobilitetet e studentëve e stafit akademik, realizimet e projekteve të ndryshme, kongrese ndëruniversitare, punë praktike e realizuar e studentëve.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

P. P. P.

P. P. P.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Duke u bazuar në Evidencë 1.24. dhe Evidencë 1.24.b, Institucioni bën organizimin vjetor të konferencave shkencore, si atyre ndërkombëtare stomatologjike, ashtu edhe konferencave studentore dhe kjo dëshmon se Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Këto aktivitete shkencore janë të akredituara dhe indeksuara me ISSN. Duke u bazuar në RVB, Institucioni publikon Revistën Optime, që funksionon prej vitit 2008.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe takimeve në Institucion në nivel institucional, AU ka Zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor dhe njëkohësisht funksionon Zyra e koordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike, të cilat merren me politikat e zhvillimit të veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe koordinon punën kërkimore të fakulteteve dhe departamenteve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar (Evidencës 1.25) Departamenti planifikon aktivitetet kërkimore dhe shkencore, gjithashtu nxit dhe inkurajon personelin akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në Konferenca Shkencore që ai organizon. Sipas këtij dokumenti Departamenti ka zhvilluar dy konferenca, Konferencën e 18-të, Stomatologjike, dhe Konferencën e dytë të Specializantëve. Gjithashtu janë aplikuar projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, ku është fituar projekti Erasmus KA 107 me Universitetin Biruni, Turqi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.</p>	<p>Në bazë të Nenit 24 të Statutit të AU, (Evidencë 1.1) Këshilli i Etikës vepron në nivel institucional, i cili diskuton probleme të etikës së jetës universitare. Këshilli i Etikës harton Kodin e Etikës dhe funksionon sipas Rregullores së Këshillit të Etikës, (Evidencë 1.26) ku parashikohet mënyra e veprimtarisë, vendimet, sanksionet dhe ekzekutimi i tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Bazuar në RVB, FSHM dhe AU në tërësi, mbështesin dhe inkurajojnë studentët në fushën e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit të tyre të vazhdueshëm. Nxitja e tyre për të marrë pjesë në Konferencat Studentore të organizuara nga Departamenti është një angazhim i përvitshëm nën kujdesin e pedagogëve udhëheqës të Departamentit të Stomatologjisë, finalizuar me botimin e një libri abstraktesh të indeksuar me</p>

Paulina

Rezauda

	ISSN. (Evidencë 1.24.b). Në Evidencë 1.24.a. dhe 1.24.b. shfaqet vetëm kopertina e Librit të abstrakteve pa ndonjë përmbajtje të paraqitur në vazhdimësi. <i>GVJ sugjeron, për një transparencë me qëllim të rritjes së cilësisë, dhe publikim të të dhënave përmes web faqes, që njëherit është edhe pasqyrim i punës të Institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se programi i studimit është i hartuar bazuar në dispozitat ligjore përse i përket organizimit të tij. Për çdo lëndë janë të përcaktuara kreditet përkatëse, të cilat ndahen në varësi të formave të realizimit të tyre. Programi është i organizuar në 10 semestra me një kohëzgjatje prej 5 vitesh, i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite dhe parashikon përfitim të 300 ECTS në total. Kurrikula e këtij programi është në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve. (Evidencë 1.6)
Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Referuar RVB-së, njohuritë e fituara nëpërmjet programit të integruar në Stomatologji, sigurojnë aftësimin e studentëve me koncepte dhe aftësi teorike dhe praktike të avancuara në një gamë të gjerë disiplinash, duke i përgatitur denjësisht për

P. P. P.

P. P. P.

	përshtatjen e menjëhershme pas përfundimit të studimeve në tregun e punës.
Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit ka objektiva për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ai synon pajisjen me njohuritë bazë dhe ka përmbajtje të tillë që t'u ofrojë studentëve njohuritë bazë dhe të avancuara.
Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Referuar planit mësimor programi i integruar përfshin brenda vetes kompleksitet të lëndëve të ndryshme të fushës së stomatologjisë. Prandaj, për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme, ekziston bashkëpunimi ndër kolegjal për zgjidhjen e këtyre rasteve, që nga kontrolli klinik, caktimi i diagnozës dhe vendosja e planit terapeutik të rastet komplekse. (Evidencë 1.6)
Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	GVJ konstaton se programi i studimit ka të gjithë elementët që parashikon legjislacioni në fuqi (VKM Nr. 41, dt 24.01.2018), për sa i përket strukturës së tij. Në dosjen e programit të studimit është paraqitur plani mësimor, ku çdo lëndë ka të përcaktuar kreditet dhe kategorizimin sipas kodeve përkatëse, formën e veprimtarive formuese (leksione, seminare, praktika) të përcaktuara me kreditet respektive, syllabuset e lëndëve të cilat përmbanin veprimtaritë dhe objektivat formues, kontrollin e dijeve dhe mënyrën e vlerësimit. Në përfundim të studimeve studentët marrin një diplomë në përputhje me parashikimet ligjore.
Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Referuar dokumentit (Stomatologji-Aneks Permbledhje Tabela). programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në: – Kategoria A: Lëndë bazë 60 ECTS, 20 % të krediteve; – Kategoria B: Lëndë karakterizuese 163 ECTS, 55 % të krediteve;

	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 44 ECTS, 15 % të krediteve; - Kategoria D: Lëndë plotësuese 23 ECTS, 8 % të krediteve; - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 10 ECTS, 3 % të krediteve; 								
Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	<p>Referuar RVB-së, 290 kredite fitohen nga zhvillimi i lëndëve dhe 10 kredite nga Tema e Diplomës.</p> <p><i>GVJ rekomandon që nga 300 kredite që janë të planifikuara në ciklin e studimeve të Programit Msc i Integruar në Stomatologji, të rezervohen së paku 15 kredite për realizimin e temës së diplomës.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #cccccc;">Nuk përmbushet</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ referuar informacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti Albanian University ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 01, datë 24.01.2020, të Bordit të Akreditimit, me afat vlefshmërie deri më 23.01.2023. Programi i studimit Msc në Stomatologji, është akredituar me Vendim të BA, Nr. 88, datë 21.09.2017.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka në përbërje tre departamente;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Stomatologjisë; 2. Departamenti i Farmacisë; 3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e	Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me

P. P. P.

P. P. P.

<p>kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Prof. Asoc” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “PhD”.</p>																																																							
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënlige për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar dokumentit (Stomatologji-Aneks Permbledhje Tabela) për vitin akademik 2021 – 2022 Fakulteti i Shkencave Mjeksore ka në përbërje 198 staf akademik gjithsej, nga të cilët 100 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 98 staf akademik me kontratë (PAK).</p>																																																							
	<p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2021-2022 është si më poshtë vijon:</p>																																																							
	<p>Departamenti i Farmacisë:</p>																																																							
	<ul style="list-style-type: none"> - 15 PAE, ndër të cilët 10 me tituj / grada; - 16 PAK, ndër të cilët, 14 me tituj / grada; 																																																							
	<p>Departamenti i Stomatologjisë:</p>																																																							
	<ul style="list-style-type: none"> - 41 PAE, ndër të cilët 31 me tituj / grada; - 33 PAK, ndër të cilët 29 me tituj / grada; 																																																							
	<p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë:</p>																																																							
	<ul style="list-style-type: none"> - 44 PAE, ndër të cilët 21 me tituj / grada; - 49 PAK, ndër të cilët 32 me tituj / grada; 																																																							
	<p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Stomatologjisë që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p>																																																							
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>8</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>15</td> <td>19</td> <td>17</td> <td>16</td> <td>14</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>SPA</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>13</td> <td>-</td> <td>10</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>10</td> <td>4</td> <td>9</td> <td>9</td> <td>12</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>41</td> <td>33</td> <td>48</td> <td>33</td> <td>40</td> <td>27</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	5	5	8	3	3	4	Prof. Asoc.	3	4	1	5	1	5	Dr./PhD.	15	19	17	16	14	9	SPA	8	1	13	-	10	1	Msc.	10	4	9	9	12	8	Totali	41	33	48	33	40	27
Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof.Dr.	5	5	8	3	3	4																																																		
Prof. Asoc.	3	4	1	5	1	5																																																		
Dr./PhD.	15	19	17	16	14	9																																																		
SPA	8	1	13	-	10	1																																																		
Msc.	10	4	9	9	12	8																																																		
Totali	41	33	48	33	40	27																																																		

	<p>Përsa më sipër GVJ konstaton se të tre njësitet bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHM) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik - organizimin dhe strukturën akademike. 			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Evidenca (E-2), dokumenton CV e stafit ndihmës, për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. Gjithashtu referuar (Evidences 1.3.a.b neni 21), personeli ndihmës akademik ndihmon në realizimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në kategorinë e këtij personeli janë laborantët, asistentët e departamenteve dhe asistent pedagog për praktikat mësimore.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sipas (Evidencës 2.1), më datë 01.03.2022, Dekania e Fakultetit të Shkencave Mjekësore ka miratuar koordinorët e programit të studimit Msc në Stomatologji dhe Laborant i Lartë Dentar. Sipas RVB, koordinori identifikon problematikat që lidhen me studentët, personelin akademik dhe atë administrativ, infrastrukturën në funksion të programit etj, me qëllim zgjidhjen e tyre dhe mbarëvajtjen e ecurisë së programit.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Në kuadër të procesit mësimor dhe veprimtarive administrative, Dekani organizon mbledhjen me përgjegjës të departamenteve, asistentët e departamenteve dhe kryesekretaren. (Evidencë 2.2).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

P. Prullina

P. Prullina

Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të evidencave të paraqitura në RVB, edhe pse jo gjithmonë të cituara në mënyrë adekuate, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka informacion të plotë për të gjitha veprimtaritë akademike në lidhje me zbatimin e planit mësimor për programin e studimit, ku përfshihen, përveç të tjerave, rregullorja e programit (Evidenca 1.4), syllabuset (Evidenca 1.9), plani mësimor (Evidenca 1.6) si dhe CV e stafit, (Evidenca 1.13).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi integruar i studimit ka një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, dhe përfshin gjithsej 300 ECTS. Një orë e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve korrespondon me 25 orë angazhim total. Programi i formimit parashikon organizimin e veprimtarive formuese bazë, karakterizuese dhe të lidhura me to ose plotësuese të trajnimit, si dhe “Veprimtari të tjera formuese” dhe marrjen e njohurive të mëtejshme përmes zgjedhjes së pavarur të veprimtarive të formimit, ndërmjet atyre të sugjeruara nga programi i studimit si dhe kryerjen e praktikës profesionale dhe përgatitjen e tezës së diplomës. Programi 5 vjeçar zhvillohet në 10 semestra, që përmbajnë 30 ECTS, përbëhet nga 34 lëndë dhe Provimit të Diplomës, që përmban 10 ECTS.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p>	
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit realizohet nga Personeli akademik i rregullt, që janë me kontratë dhe personeli akademik i ftuar për mbajtjen e ligjeratave. Në planin mësimor janë të përshkruara orët mësimore javore dhe semestrare, seminarët, punët laboratorike me ngarkesë orësh prej 25 orë javore. (Evidenca 1.9). Sipas RVB, (Evidencës 2.9), evidentohet raporti semestral i pedagogut dhe është paraqitur raporti i pedagogut M.H./staf me kohë të pjesshme/, i cili ligjeron lëndën e “Informatikës së Aplikuar Mjekësore”.</p> <p>Ecuria e lëndës, puna e vlerësuar e pedagogëve përmes pyetësorëve, evidenca, kalueshmëria, përmbushja e</p>

P. P. P.

P. P. P.


	objektivave mësimorë, vërejtjet, janë të përshkruara në (Evidencën 1.18).			
Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Referar nenit 12 të (Evidencën 1.4), GVJ konfirmon ekzistencën e rregulloreve për transferimin e studimeve brenda të njëjtit cikël, midis programeve të njëjta ose të ngjashme, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme. Sa i përket linkut të dhënë në RVB, nuk është i aksesueshëm https://albanianuniversity.edu.al/wpcontent/uploads/2017/03/Manuali_i_Studentit.pdf . Praktikohet java orientuese. Departamenti nëpërmjet koordinatorit, figurave drejtuese dhe personelit akademik bën prezantimin e programit të studimit përpara studentëve duke paraqitur të gjithë informacionin e nevojshëm mbi lëndën, planprogramin, detyrimet akademike të studentit, etj (Evidencë 2.6).			
Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit disponon syllabuset e të gjitha lëndëve që zhvillohen. Kryesisht ato kanë të dhënat e kërkuara nga dispozitat ligjore në fuqi mbi emërtimin, kategorizimin, kreditet, ndarjen dhe numrin e orëve të Leksioneve, Seminareve, Laboratoreve, Praktikave si dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. (Evidencë 1.9)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Referuar RVB-së, çdo fillim viti akademik, departamenti me koordinatorët e lëndëve rishikon syllabuset dhe sipas propozimeve, mund të bëjë freskimin e lëndëve deri në 20% dhe ti përcjellë në Zyrën për Zhvillim Akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se programi i integruar i studimit është strukturuar dhe ofrohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Institucioni shqyrton disponueshmërinë e stafit akademik, teknik dhe administrativ, si dhe infrastrukturën, në mënyrë që të mundësohet realizimi i programit të studimit dhe të ketë një ecuri normale të procesit mësimor.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Bazuar në dokumentacion dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit rezulton i duhuri në përçimin e njohurive. Sipas (Evidencës 2.8), në formë tabelare, është paraqitur ndër vite një numër i të diplomuarve nga programi i studimit të Stomatologjisë pranë AU, të cilët janë integruar në tregun e punës.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët/modulet, organizimi i tyre dhe vlerësimi mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Programi synon që formimi teorik dhe shkencor i studentëve t'u jap aftësinë për të punuar si stomatolog në mënyrë të pavarur dhe kapacitetin për t'u thelluar në studime përmes një aktiviteti kërkimor shkencor të ciklit të III-të të studimeve. Kurrikula e studimit në fushën e Stomatologjisë përfshin lëndë të formimit paraklinik dhe klinik. Ato janë të shpërndara përgjatë 5 viteve, ku në dy vitet e para studentët njihen me lëndët e përgjithshme të profilit mjekësor dhe lëndët e formimit stomatologjik paraklinik. (Evidencës 1.6)
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i	Struktura e programit, përmbajtja, zhvillimi e monitorimi dhe raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave". <i>GVJ sygjeron që të punohet edhe më tej në drejtim të përshtatjes sa më të mirë me kërkesat e kohës dhe të zhvillimit shkencor në</i>

shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<i>stomatologji dhe të përafrohet edhe më shumë me programe të ngjashme ndërkombëtare.</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Referuar përmbatjes dhe syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi, GVJ konstaton se ai ofron dije teorike dhe praktike për studentët. Dijet dhe aplikimet praktike, përveç ambjenteve të cilat vetë Albanian University vendos në dispozicion, zhvillohen edhe në ambiente të tjera me të cilat universiteti ka marrëveshje, siç janë: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ISHP Tiranë, etj.
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit të Stomatologjisë, GVJ evidentoi praktikën e punës në IAL, ku në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik. Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës dhe pasi miratohet nga Departamenti propozimi shqyrtohet në Dekanat. Bazuar në (Evidencë 1.9) tek Syllabuset e lëndëve janë të përshkruara programet e lëndëve /moduleve, të cilat përditësohen vazhdimisht.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.	Ky program studimi, ofrohet me kohë të plotë dhe përfshin krahas formimit teorik bashkëkohor edhe pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore, të cilat kryhen në Institucionin që realizon programin, por edhe në Institucionet mbështetëse me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, sipas procedurave dhe protokolleve mjekësore të aprovuara dhe që janë në zbatim në veprimtarinë e tyre. Për këtë qëllim janë ngarkuar udhëheqës praktikë dhe tutorë, që janë specialistë në Stomatologji
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e	Programi i studimeve në stomatologji, është hapur bazuar në kërkesat e tregut të punës për specialistë në këtë profil. Programi jo vetëm plotëson nevojat e tregut të vendit, por jep një kontribut të vyer edhe në rajon. Në këtë drejtim, hapja e këtij

studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	programi studimi konsiderohet si një kontribut i madh publik në fushën e dentistrisë në vend dhe në rajon.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas të dhënave të cilat posedohen, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, me qëllim të përmirësimit të përbajtjes së programit të integruar të studimit dhe përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut e punës.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor dhe kohëzgjatja e programit prej 5 vitesh, mundëson njohuri të avancuar. <i>GVJ rekomandon që stafi akademik e studentët të shtyhen e të motivohen që rastet e punuara në klinikë të publikohen në revista ndërkombtare të platformave prestigjioze, si Web of Science e Scopus.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit me kohë të plotë apo të pjesshme plotësojnë kërkesat e vendosura nga legjislacioni në fuqi.

P. P. P.

P. P. P.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit, bazuar në (tabelen nr.7 Evidences Stomatologji-Aneks Permbledhje Tabela) për 5 vite akademike është:

1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 54 pedagogë nga të cilët 35 PAE dhe 19 PAK (65% /35 %)
2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 70 pedagogë nga të cilët 44 PAE dhe 25 PAK (63 % /37 %)
3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 68 pedagogë nga të cilët 38 PAE dhe 29 PAK (57.3 % / 42.7 %):
4. Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 60 pedagogë nga të cilët 36 PAE dhe 23 PAK (60 % / 40%);
5. Për vitin akademik 2017 - 2018 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 61 pedagogë nga të cilët 40 PAE dhe 21 PAK (63 % / 37%);

Tituj/grada	2017-2018		2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022	
Prof.Dr	4	4	3	5	4	5	6	3	5	2
Prof.As.Dr	4	5	2	6	3	6	5	5	5	5
Dr/PhD	14	8	14	8	15	9	18	9	16	10
Msc (Dr në proces)	5	1	6	1	5	2	2	0	1	0
Msc	13	5	11	4	12	7	13	8	8	2
Në total	40	23	36	24	39	29	44	25	35	19

Ndërkohë pasi analizuam informacionin e dhënë në tabelat /Evidencë 1.12./ për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAK

Paulina

Republika

	2017-2018	68.3 %	31.7 %
	2018-2019	71.4 %	28.6 %
	2019-2020	70 %	30 %
	2020-2021	72. %	28 %
	2021-2022	69.5 %	31.5 %
	Nga tabela rezulton që ngarkesa mësimore për këtë program studimi, mbulohet në masën 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.		
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se fusha akademike e personelit të angazhuar ishte në përputhje me lëndët/modulet specifike që ata mbulonin në kuadër të programit të studimit. I gjithë stafi mësimor i përfshirë në mësimdhënie përbëhet nga pedagogë fusha e kërkimit akademik dhe shkencor e të cilëve është ajo e mësimdhënies.		
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Programi i studimit realizohet dhe implementohet nga një numër i lartë profesionistësh të fushës së stomatologjisë, nisur kjo nga specifika e programit të studimit. Janë pikërisht këta profesionistë, të cilët janë vetë pjesë aktive e tregut të punës, që e njohin nga afër zhvillimin dhe nevojat e tij dhe risitë e fushës. Opinionet, propozimet apo kërkesat e tyre bëhen shpesh pjesë e diskutimeve në mbledhjet e departamentit nga ku nxiten dhe ndryshime të mundshme në përmirësim të realizimit të programit të studimit.		
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Kabinetet laboratorike janë të pajisura me sisteme kompjuterike dhe ofrojnë mundësinë e laboratorëve digjitale në Stomatologji. Institucioni bashkëpunon me firma të njohura të Europës dhe më gjerë në tregun e materialeve dhe aparaturave mjekësore bashkëkohore, me të cilat ka bërë të mundur furnizimin ritmik e të mjaftueshëm me të gjithë preparatet dhe pajisjet e tjera të shërbimit stomatologjik, në sasinë e kualitetin e nevojshëm, shoqëruar këto me certifikatën e cilësisë dhe të origjinës së produkteve dhe instruksionet e përdorimit të tyre.		

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione partnere të profilit stomatologjik, me karakter akademik apo klinik/spitalor, ndihmojnë departamentin në realizimin e objektivave të programit të studimit. (Evidencë R.2.a).
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë vizitës dy ditore, u vërejt se Departamenti mban kontakte me studentët e tij. Në diskutim me studentët u dëshmuua se secili nga grupet mësimore ka senatorin e tij i cili është përfaqësuesi i grupit dhe relatton në lidhje me shqetësimet, problematikat apo propozime të ndryshme të studentëve. Në komunitetin studentor funksionojnë dhe grupet e tutoriatit studentor të cilët zhvillojnë takime periodike me studentët duke sjellë një tjetër zë mbi çështje apo propozime për përmirësim. Këtë relacione shqyrtohen në departament dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Departamenti mban kontakte edhe me të diplomuarit duke i inkurajuar që të angazhohen dhe të marrin pjesë në kuadër të formimit të tyre të vazhdueshëm përmes konferencave që organizohen në kuadër të Universitetit. Kontaktet me studentët e diplomuar realizohen duke këmbyer opinione në lidhje me mundësitë e përmirësimit të programit të studimit. Megjithatë në linkun e dhënë në RVB, sërish GVJ konstaton se linku i dhënë nuk funksionon. https://albanianuniversity.edu.al/sq/performance-akademike-

P. P. P.

P. P. P.

	e-studenteve-tediplomuar-dhe-niveli-i-punesimit-te-tyre-ne-tregun-perkates-te-punes/.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.	Sipas (Evidencës R.2. a) institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi, ku departamenti mbështetet në bashkëpunimin me institucione partnere. <i>GVJ rekomandon që MoU e paraqitura në (Evidencën R.2.a), me Institucionet partnere të funksionalizohen, me qëllim që programi të përditësohet, përshtatet dhe të riorganizohet edhe më tej.</i>			
Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme	Bazuar në (Evidencë 2.17), shihet se Programi bëri implementimin e një lënde të re “Dentistria Digjitale” për vitin e III-të dhe të V-të. Departamenti bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë partnere brenda vendit, Urdhërin e Stomatologut, institucione publike të fushës së shëndetësisë, shoqata profesionistësh apo studentore të fushës së mjekësisë, si dhe institucione partnere të huaja, me të cilët këmbëhen opinione dhe propozime me qëllim përshtatjen dhe përditësimin e programit me të rejtat e fundit të fushës..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i integruar i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat e tij, në lidhje me formimin e përgjithshëm teorik, aftësimin praktik dhe krijimin e bazave për thellimin në studime të mëtejshme akademike apo kërkimin shkencor. Objektivat specifike të programit të studimit janë ofrimi i një sërë njohurish teorike dhe praktike, si dhe aftësive relevante, për studentët, në ushtrimin e detyrës së stomatologut. <i>GVJ rekomandon që kërkimi shkencor të pasurohet përmes rasteve klinike që kanë implikim shkencor.</i>

P. Mulla

P. Molla

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nisur nga vizita në institucion si dhe të dhënat që përmban DVV GVJ vëren se në FSHM / AU, njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën farmaceutike të studimit. Njësitë bazë (departamentet) janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit akademik mësimor. Ato ndiqnin nga afër zhvillimin dhe realizimin e lëndëve, kanë gjithmonë kontakte me personelin akademik, adresonin problematika të ndryshme të studentëve si dhe koordinonin veprimtaritë kërkimore të personelit mësimdhënës</p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Referuar RVB-së, studentët, inkurajohen dhe përfshihen si pjesë aktive në aktivitete të cilat janë të përvitshme të organizuara nga departamenti i pedagogëve të përzgjedhur që bëjnë punë kërkimore.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Mund të thuhet se bazuar në RVB Programi i studimit i ofruar nga AU përfshin edhe hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. (Evidencë 1.9)</p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Duke u bazuar në evidencë (RVB dhe takimet në IAL), GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Mjekësore mbështetet financiarisht nga institucioni për realizimin e veprimtarisë kërkimore dhe shkencore. Me propozim nga Senati Akademik dhe miratim nga Bordi i Administrimit, institucioni siguron një fond vjetor për zbatimin e veprimtarive mësimore dhe mbështet kërkimin shkencor.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/fondi-i-kerkimit-shkencor/.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në afatin sa më të shkurtë kohor të punohet teknikisht në web faqe, pasi sërish linqet e dhëna në RVB nuk janë të aksesueshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

P. P. P.

P. P. P.

Standardi II.8**Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Në këtë drejtim Fakulteti ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme me karakter kërkimor, të cilat mund të ndihmojnë konkretisht dhe realisht në përfshirjen e institucionit në projekte të reja për realizimin e objektivave të tij në drejtim të kërkimit shkencor. Bazuar në (Evidencë R.2 a), Departamenti i Stomatologjisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore inkurajojnë personelin akademik në angazhimin në projekte kërkimore shkencore, në kuadër të fakultetit apo dhe individualisht.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ e vlerëson si shumë të rëndësishme dhe si një mundësi të padiskutueshme që projektet kërkimore-shkencore të intensifikohen edhe më tej duke bashkëpunuar vazhdimisht me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Puna kërkimore e thelluar është një detyrim për të gjithë studentët, të cilët përmbyllin programin e studimit me hartimin e punimit të diplomës, i cili është një finalitet i të gjithë aktivitetit formues dhe njohurive të thelluara të studentit që përfundon një program të integruar Master Shkencave.</p> <p><i>Andaj, GVJ sugjeron që studentëve që janë në përgatitje të temës së diplomës tu sigurohet mundësi më e gjatë kohore për realizimin dhe shtjellimin e temës së diplomës, duke u thelluar më tepër në punë praktike, duke i dhënë një rëndësi të vecantë implikimit klinik për realizimin e hulumtimeve kërkimore shkencore.</i></p>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	<p>Sipas evidencës, GVJ konfirmon se në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Këto aktivitete organizohen në nivel departamenti dhe në nivel institucional dhe duke bazuar në bashkëpunime të ndryshme. Këto aktivitete përfshijnë konferenca shkencore, seminare dhe leksione të hapura duke përfshirë stafin akademik dhe studentët.</p>

	Sipas (Evidencës 1.24.a) viti akademik 2020-2021 përkon me realizimin e Konferencës së 18 të Ndërkombëtare të Stomatologjisë, aktivitet i akredituar nga QKEV. Ky është një aktivitet i përvitshëm, i cili realizohet nga fillimet e funksionimit të programit të stomatologjisë ofrohet nga Albanian University.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Një nga veprimtaritë tashmë të konsoliduara në Albanian University rezulton të jetë zhvillimi i procesit mësimor. Si në dokumentacionin mbështetës të raportit, edhe në takimet në institucion, me drejtuesit, personelin akademik, studentët, u deklarua se aktualisht institucioni aplikon metodat më inovative të mësimdhënies në fushën e shkencave mjekësore.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse / Njësia e Sigurimit të mbrendshëm të Cilësisë kanë përpiluar Platformën digjitale në Mars 2021 ku përdorin pyetësorët e studentëve gjatë periudhës mësimore. Sipas (Evidencës 6.8), shihet se është zhvilluar online vlerësimi i brendshëm.

P. P. P.

Delmala

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit. Marrja e mendimeve të studentëve për mësimdhënien dhe vlerësimin e dijeve bëhet jo vetëm nëpërmjet pyetësorëve, por edhe përmes takimeve mujore me fokus grupet me studentët e të gjitha viteve. (Evidencës 3.2). Përgjigjet e pyetësorëve të studentëve japin indikacione në lidhje me metodat e mësimdhënies nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, të dhënat e pyetësorëve bëhen publike nga Zyra e NJSBC nëpërmjet publikimit të tyre në formën e broshurave, të cilët vihen në dispozicion të personelit drejtues duke mundësuar kështu vlerësimin e burimeve njerëzore të programit të studimit dhe shikimin e mundësive për përmirësim të vazhdueshëm. (Evidencë 3.3)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Rezultatet e marra nga pyetësorët analizohen nga departamenti, si monitoruesi i cilësisë së mësimdhënies. Të dhënat mbi vlerësimin e pedagogëve së bashku me komentet e studentëve për ta, u vihen në dispozicion pedagogëve në mënyrë konfidenciale me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Praktikrat më të mira promovohen në mbledhjet e departamentit duke i përcaktuar si promotorë të ecurisë së mirë të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikrat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet,</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve përfshijnë si leksione teorike (në auditor), ashtu edhe leksione me qëllime praktike, kohë e përkushtuar për hartimin e projekteve dhe aktiviteteve praktike dhe studimin</p>

P. Mulla


P. Mulla

<p>praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>vetjak të studentit. Nëpërmjet kalendarit akademik të miratuar nga Dekani në çdo fillim viti akademik realizohet procesi mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe aftësimi praktik. (Evidencë 3.4).</p> <p><i>GVJ rekomandon që për shkak të transparencës në punë orari i studentëve për realizimin e mësimit të publikohet On/line. Pra jo vetem, në hapësirat e fakultetit, por ai të jetë i qasshëm për të gjithë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Stafi akademik u përgjigjet kërkesave të studentëve, duke ofruar mënyra dhe metoda alternative të të nxënies dhe përmirësimit në fushën e mësimdhënies. Sipas (Evidencës 3.5), personeli akademik i programit të studimit ka një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kryesisht i përket grup moshës 36 — 45 vjeçare. Bazuar në (Evidencën 1.13), një pjese e stafit akademik kanë studiuar jashtë vendit, ashtu që eksperiencia dhe përvoja e fituar e tyre vihet në dispozicion të mësimdhënies pranë programit të stomatologjisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Sipas (Evidencës 3.6), konstatohet se personeli akademik gjen mbështetjen e institucionit, i cili realizon herë pas here trajnimin e tij për përditësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe për ti përshtatur ato me te rejat e kohës.</p> <p>Sipas linkut të paraqitur në RVB, https://albanianuniversity.edu.al/sq/agjenda-e-trajnim-it-te-stafit-akademik/, kuptojmë se kemi të bëjmë me një paraqitje tabelare të agjendës së trajnimit në mësimdhënie të vitit akademik 2017/2018. Megjithatë, nxitja e përdorimit të teknologjisë digjitale për të stimuluar mësimnxënien dhe interaktivitetin gjatë orëve mësimore, shtrirja e linjave të internetit në të gjitha ambientet ku zhvillohet procesi mësimor, duke përfshirë edhe sallat e praktikës, të cilat janë pasuruar me kompjuter dhe monitorë, vjen në ndihmë të konkretizimit të këtij procesi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore</p>

P. P. P.

P. P. P.

	të transmetimit të njohurive në funksion të të nxënit. Platforma Microsoft Teams, është një tjetër mundësi, që shfrytëzohet nga personeli akademik dhe studentët, me të gjithë potencialin inovativ që ajo ofron (Evidencë 3.7).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ është e mendimit se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie nga AU është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve dhe kjo mund të vërtetohet (deri në një shkallë) përmes karrierës së tyre akademike (Evidenca E-2). Po ashtu perceptimi i studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies konfirmon aftësitë/kompetencën e stafit akademik në mësimdhënie.
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative në përdorim në IAL dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies.
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik mbështetet dhe inkurajohet nga IAL në procesin e përmirësimit të procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të metodave inovative interaktive dhe diskutimeve mbi zhvillimet e fundit në fushat e studimit të lëndës dhe të kërkuara nga tregu i punës. Kalimi në sistemin online të mësimdhënies e ka bërë të domosdoshëm përdorimin e teknikave dhe metodave interaktive me qëllim rritjen e fokusit dhe interesit të studentëve, me anë të aktivizimit e të gjithë studentëve në punët praktike, projektet, përfshirjen në punën në grup dhe projekte dhe kërkim shkencor nën udhëheqjen e personelit akademik të fushës.
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe	GVJ është e mendimit se format dhe metodat e mësimdhënies, inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit dhe sigurojnë mbështetjen e studentit. Gjithashtu format dhe metodat e mësimdhënies të paraqitura në programin e studimit dhe

mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	syllabuset përkatëse synojnë përgatitjen e një stomatologu të ardhshëm jo vetëm me aftësi profesionale, por edhe pavarësi mendimi e veprimi që e përfshijnë atë në vendimmarrje dhe gjykime.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Bazuar në RVB si dhe vizitën në institucion, rezulton se AU vë në dispozicion ambiente të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditorët, laboratorët, dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Duke u bazuar në evidencë dhe gjetjet gjatë vizitës në institucion, ambientet e dedikuara për procesin mësimor ishin funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, me kompjutera, sistem wi-fi si dhe pajisje laboratorike cilësore që mundësojnë zhvillimin e teorisë dhe praktikës në mënyrë cilësore dhe plotësojnë nevojat e studentëve. Laboratorët në të cilët kryhet praktika mësimore-klinike dhe paraklinike e parashikuar sipas programit të studimit pasqyrohen si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i Kimisë së Përgjithshme Inorganike; • Laboratori i Kimisë Organike; • Laboratori i Anatomisë I,II Laboratori i Histologjisë; • Laboratori i Fizikës; • Laboratori i Informatikës;

P. P. P.

P. P. P.

	<ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i Praktikës Paraklinike I (pjesë e Klinikës universitare); • Laboratori i Praktikës Paraklinike 2 (pjesë e Klinikës universitare); • Laboratori i Protetikës (pjesë e Klinikës universitare);
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka investuar në teknologji moderne për mësimdhënien dhe për punën kërkimore. Të gjitha klasat ku kryhet procesi mësimor janë funksionale dhe të pajisura me PC; video projektor; sistem IT; WI-FI; që ndihmon stafin mësimor dhe studentët, dhe lehtëson aksesin e tyre në dokumentacion elektronik, pajisjet dhe materialet didaktike.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV, dhe nga vizita në institucion, e posaçërisht në sallën e bibliotekës apo takimi me studentët, GVJ konfirmon se biblioteka e AU, u ofron studentëve dhe pedagogëve një literaturë akademike adekuate për programin dhe në disa formate. Biblioteka përditëson dhe pasuron fondin dhe i siguron botimet e përditësuar, duke e bërë atë të disponueshme për studim dhe kërkim shkencor. Kjo literaturë iu komunikohet studentëve nga pedagogët e lëndëve në fillim të çdo semestri. Atyre u komunikohen dhe mënyrat e aksesimit të kësaj literature. Kopje të të gjitha librave bazë si në gjuhën shqipe ashtu dhe atë angleze, gjenden në bibliotekën e institucionit, e cila pasurohet çdo fillim viti akademik që burojnë nga departamentet.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Duke u bazuar në evidencë, dhe vizita në institucion, sidomos nga takimi me studentët, GVJ konstaton se biblioteka e institucionit garanton numër të konsiderueshëm të botimeve. Biblioteka përditësohet vazhdimisht me tituj mbi literaturën akademike më të fundit dhe alternative, në bazë të propozimeve që vijnë nga përdoruesit e saj.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të</p>	<p>Gjatë vizitës dyditore në institucion u konstatua se personeli akademik si dhe studentët kanë mundësinë jo vetëm të shfrytëzojnë fondin e pasur të bibliotekës, por edhe librarinë online në EBSCO HOST library. Kjo hapësirë iu siguron atyre kërkimin në internet të një game akoma më të gjerë literaturës në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Biblioteka</p>

përafërta me programin e studimit.	online përfshin gjithashtu ka libra open access të disponueshëm.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Referuar RVB-së, infrastruktura e FSHM, laboratorët, salla e Bibliotekës dhe laboratorit i informatikës, klinika stomatologjike etj, mundësojnë përdorimin jo vetëm për aktivitetin mësimor siç janë detyrat e kursit apo projekte të ndryshme, por dhe punë kërkimore shkencore nga ana e pedagogëve dhe studentëve të cilët punojnë për temën e diplomës dhe punimet që prezantojnë në konferencat studentore. Laboratorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme dhe të teknologjisë së viteve të fundit për zhvillimin optimal të praktikave nga ana e studentëve, si Mulazhe, 50 Fantoma, Turbina, 'Materiale Dentare të shumëllojshme, të cilat mund të shfrytëzohen prej tyre edhe për realizimin e studimeve të ndryshme.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Albanian University për shkak të situatës së kaluar /Pandemia Covid- 19/ gjatë viteve të fundit, ka vënë në përdorim Platformën Online/ Microsoft Teams dhe atë Exam.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sipas RVB-së studentët kanë në dispozicion sekretarinë online nëpërmjet të cilës mund të aksesojnë informacionin e nevojshëm mbi rezultatet e provimeve, apo dokumentacion tjetër të nevojshëm.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Bazuar në RVB dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se stafi akademik udhëzon studentët në zgjedhjen e temave të diplomave si dhe asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre (kjo ndiqet nga një pedagog udhëheqës që ndihmon në punën kërkimore dhe mbështet zhvillimin e temës si dhe një pedagog ndihmës). Udhëheqësi ndjek në vazhdimësi studentin në zhvillimin dhe hartimin e temës së diplomës. Udhëheqësi gjithashtu, vë në dispozicionin e tij të gjithë data-bazën e nevojshme në hartimin e temës përkatëse të studentit. Udhëheqësi, në programin e studimit në fushën e

	stomatologjisë, ndjek deri në 5 studentë njëkohësisht. (Evidencë R.2.b).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	AU ka të ngritur Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë NJSBC, që përbën një mekanizëm shumë të vlefshëm për monitorimin, kontrollin dhe supervizimin e programeve të studimit në mënyrë të paanshme. Një mekanizëm tjetër për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e mësimdhënies, është edhe roli i Koordinatorit të Programit të Studimit si dhe zyrave të tjera të Universitetit. Këta aktorë sigurojnë të dhënat e nevojshme për NJSBC për të qenë në gjendje të monitorojë dhe vlerësojë aktivitetin e çdo programi studimi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie në nivel njësie janë të lidhura me rolin e kordinatorit të programit të studimit, grupi i cilësisë në nivel departamenti dhe grupi i sigurimit të brendshëm të cilësisë. Me asistencën e Zyrës së Kurrikulave, para çdo fillim viti të ri akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, kurrikula, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore apo vëzhgimeve, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna vihen në dispozicion të NJSBC nga Departamenti & sekretaria

P. P. P.

Delinda

	mësimore. Kjo njësi përbëhet nga dy ose tre anëtarë, personel i brendshëm i departamentit. (Evidencë 1.17).
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Strukturat dhe njësia bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të trajnimeve, leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në (Evidencën 3.11) një numër i lartë pedagogësh, lektorë ose asistent lektorë janë pjesëmarrës në konferenca të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe angazhohen në botime shkencore në revista vendase dhe të huaja prestigjioze, janë pjesëmarrës në projekte kërkimore shkencore, apo kualifikohen në forma të ndryshme individualisht në aktivitete të formimit në vazhdim. (Evidencë 3.10). Kjo eksperiencë e akumuluar vihet në shërbim të procesit akademik, të udhëheqjes së punimeve të diplomës, udhëheqjes së punëve kërkimore të studentëve, botimeve të studentëve në revista shkencore të rrjeteve studentore, duke përcjellë eksperiencën dhe njohuritë.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Personelit të angazhuar në këtë program studimi i kërkohet të përmirësohet vazhdimisht, kjo lidhur me kërkesën për kualifikim dhe avancim në kërkimin shkencor, duke monitoruar nivelin e tyre të kualifikimit, publikimin në revista shkencore, pjesëmarrjen në konferenca, projekte dhe mobilitete të ndryshme. Gjithashtu institucioni organizon trajnime leksione të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj me qëllim mbështetjen e stafit në këtë drejtim. Këto veprimtari jo vetëm ndihmojnë në kualifikimin e tyre por edhe në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie të stafit akademik për këtë program studimi.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Referuar RVB-së, në stimulimin e implementimit të metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, vetë personeli akademik dëshmon nëpërmjet punës së përditshme, integrimin e metodologjive të reja dhe bashkëkohore në procesin mësimor dhe akademik.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik	Sipas (Evidencës 2.9 dhe 1.19), metodologji të inovative në procesin mësimor dhe përvetësimin të tyre nga studentët,

P. P. P.

P. P. P.

testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	ecurisë së programit të studimit, rezultatet e të nxënit, kalueshmëria dhe komente të mundshme mbi to, kryhet nëpërmjet raporteve semestrale që ai realizon dorëzohen në përfundim të çdo cikli leksionesh.			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka përfshirë edhe personel nga struktura të tjera të brendëshme të AU dhe nga bashkëpunëtor të jashtëm. Referuar vizitës në institucion, Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë ka realizuar një sër vepritarishë si trajnime, tryeza të rrumbullakta, leksione të hapura me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit (Evidencë 1.4). Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin google classroom apo platformat elektronike që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët edhe përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive,	Procedura që aplikohet nga AU paracakton detyrimin e stafi akademik për të informuar studentët në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuse

P. Mulla

P. Mulla


dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	në fillim të çdo lënde apo moduli. Gjatë vizitës në institucion na u referua nga stafi dhe studentët e këtij program studimi se ky informacion u jepet studentëve edhe në departamentin e stomatologjisë. Në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme (Evidencë 1.9).			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve mësimore u japin studentëve hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: <ul style="list-style-type: none"> • provimeve të pjesshme; • provime ne perfundim të lëndëve; • praktikë profesionale; • temë diplome; Cdo formë testimi vlerësohet me pikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Proçedura e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit parashikon vlerësimin e studentëve në mënyrë të vazhdueshme duke pasur si qëllim: <p style="margin-left: 40px;">nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit; realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit; duke e ndarë notën në disa komponentë;</p>




	<p>Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementeve të mëposhtëm;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi Përfundimtar 60 pikë (60%); • Provimi i Ndërmjetëm 20 pikë (20%); • Pjesëmarrja aktive në Seminare 10 pikë (10%); • Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave, 10 pikë (10%);
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, format e testimit elektronik të njohurive janë përdorur përgjatë periudhës së pandemisë së Covid- 19, ku nëpërmjet platformave të vëna në dispozicion të universitetit, (Platforma Exam.Net dhe Platforma Microsoft Teams), është bërë realizimi i moduleve dhe provimeve. (Evidencë 3.7).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar nenit 21 të rregullores së programit të studimit (Evidencë 1.4), studentët merren në provim nga komisionet e lëndëve të përbërë nga titullari i lëndës/lektori dhe asistent pedagogët. Testimi i njohurive nëpërmjet provimit përfundimtar realizohet në mënyrë të sekretizuar, ku tezat e provimit kanë anonimitet të plotë. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimat e çdo studenti. Korigjimi i provimeve kryhet brenda 7 ditësh nga zhvillimi i provimit dhe rezultatet e tyre plotësohen në procesverbal nga ana e pedagogëve dhe më pas dorëzohen në Sekretarinë mesimore.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit</p>	<p>Referuar RVB-së, vlerësimi i dijeve, kryhet përgjatë gjithë semestrit, nëpërmjet formave të ndryshme të testimit. Forma kryesore e testimit të ndërmjetëm, siç janë modulet, por edhe vlerësimet të cilat bëhen gjatë seminareve apo laboratoreve, orientojnë studentët në lidhje me ecurinë e tyre në lëndën</p>

për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	përkatëse duke evidentuar dobësitë apo aspektet për përmirësim dhe duke stimuluar procesin e mësimnxënies.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësia bazë është në rolin e monitorueses dhe mbikqyrëses lidhur me respektimin e procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik lidhur me rregullat e realizimit të detyrave dhe detyrimeve për përmbylljen me sukses të programeve lëndore. Një sër elementësh që lidhen me mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mirat për të shmugur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas Nenit 26, të rregullores së programit të studimit, (Evidencë 1.4) me përfundimin e provimit, kryetari i komisionit të provimit ose pedagogu i lëndës e dorëzon fletën e provimit të plotësuar në Sekretarinë Mësimore brenda 7 ditësh nga zhvillimi i provimit.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë Msc në "Stomatologji" respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlersimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit Neni 26 (Evidencë 1.4). Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në datën e përcaktuar nga pedagogu i lëndës për kunsultimin e provimit ose përmes sekretarisë mësimore.
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Bazuar në rregulloren e brendshme të programit të studimit cdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlersim të notës përmes komisioneve të posacme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim (kriteri 8 Evidencë 1.4). Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore ngre një komision ad hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit “Master i Shkencave” në Stomatologji garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Në përfundim të studimeve, të diplomuarit janë të pajisur jo vetëm me njohuri të thelluara në fushën e stomatologjisë dhe të shëndetit dentar, por edhe të pajisur me dijeni edhe në drejtim të zhvillimit të kërkimit shkencor të thelluar në këtë fushë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton se programi i studimit ka përputhje me disa nga praktikat më të mira europiane dhe është bazuar në nevojat që ka ky profesion si dhe në trendet e zhvillimit të stomatologjisë dhe teknologjisë që aplikohet në të. Mund të thuhet se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, mbështetur edhe nga infrastruktura moderne; aftësi sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit, nëpërmjet lëndëve të tilla si: Informatikës së Aplikuar Mjekësore, hartimit të politikave, planifikimit strategjik dhe hartimit të programeve e projekteve, apo njohuri të komunikimit dhe ndërveprimit në gjuhën angleze duke përdorur terminologjinë e specialitetit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Bazuar në RVB, GVJ vëren se Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat përkatëse mbi aftësitë dhe kompetencat që pritet të fitojë studenti paraqiten jo vetëm në përmbajtje të programit të studimit, por në çdo syllabus të veçantë. (Evidencë 1.9).
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të	Bazuar në RVB si dhe gjetjet gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëren se studentët njihen që në fillim të lëndës/modulit në lidhje me mënyrën e vlerësimit përfundimtar. Në javën e fundit të

P. P. P.

P. P. P.

rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	lëndës studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton se Personeli akademik me kohë të plotë integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Departamenti, organizon leksione të hapura ose seanca trajtimi me pedagogë të tij ose dhe lektorë të ftuar (vendas ose të huaj) të cilët kontribuojnë në zgjerimin e njohurive të studentëve të programit të stomatologjisë. (Evidencë 3.14).
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Sa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, departamentet dhe të gjitha strukturat e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, bashkërendojnë punën, ofrojnë ndaj studentëve të gjithë infrastrukturën e nevojshme për t'i dhënë studentëve mundësi të zhvillojnë praktikat dhe laboratorët profesionale. Ky personel është në kontakt primar me pacientin dhe kontrollon studentin në të gjitha fazat e trajtimit të tij. Kontrolli i personelit akademik siguron edhe cilësinë e protokollit dhe të vazhdimësisë klinike të trajtimeve dentare të kryera në Klinikën Universitare.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Bazuar në RVB, GVJ konstaton se objektivi final i personelit akademik është të nxënit e njohurive, autonomia e gjykimit dhe aftësimi për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme profesionale.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Këto diskutime nxisin studentët për zhvillimin e mendimit individual në bazë të njohurive të akumuluar si dhe shërben si shtysë për thellimin e tyre në tema kërkimore, të cilat studentët mund t'i paraqesin në konferencat studentore që organizon departamenti apo t'i përzgjedhin si tema të diplomës në përfundim të studimeve të tyre. (Revista OPTIME Proceeding Book, ISSN 2220 - 461X A Viti i x-te i Botimit, Nr.1, Qershor, Evidencë 3.16).
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore	Bazuar në përmbushjen e këtij kriteri vlersohen si pozitive në këtë aspekt nismat për të aplikuar në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim

P. P. P.

Definitive

e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca. Departamenti i Stomatologjisë i organizon në menyrë të përvitshme konferencën studentore. Mbështetja e kërkimit shkencor studentor konsiston jo vetëm në mbështetjen financiare por edhe në krijimin e oportuniteteve për botime në organizma studentore ndërkombëtare.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	GVJ konstaton se institucioni financoi pjesëmarrjen e studentëve më të mirë në aktivitete shkencore të organizuara nga organizata partnere, sic është ajo Brainstorm, të zhvilluara jashtë vendit, si Medical Summer School, Winter Medical School, Trajnime Multidisiplinare 5 etj (Evidencë 1.27).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni ka të përcaktuar qartë procedurën për diplomimin e studentëve të tij në përfundim të studimeve, Nenet 30, 31, 32, 33 (Evidencë 1.4). Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplomë pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik (duke përfshirë Koordinatorin e programit) udhëzojnë dhe ndihmojnë studentët duke siguruar informacion dhe materiale të nevojshme për temën e diplomës. Performanca dhe progresi i studentëve gjatë periudhës së punimit të temës së diplomës ndiqet dhe monitorohet përmes takimeve të rregullta me udhëheqësit. Këto takime fillimisht fokusohen në përcaktimin e temës dhe strukturës së punimit, dhe më vonë në hartimin dhe zbatimin e metodës së përcaktuar të studimit. Takimet përfundimtare i kushtohen tërësisht vlerësimit të analizës së kryer dhe interpretimit të rezultateve. Realizimi i temës kalon 3 faza kontrolli, në periudhë kohore të paracaktuara: fund janari, fund

P. Milićević
P. Milićević

	<p>marsi, fund maji, gjatë të Cilave, studentit i kontrollohet materiali i grumbulluar nga udhëheqësi i temës, dhe më pas firmoset dokumentacioni i përgatitur, nëse udhëheqësi është i bindur për cilësinë e punimit. (Evidencë 3.9)</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë "programi i studimit përmbillet me punim diplome. Studenti prezanton Temën e Diplomës përpara një komisioni të Diplomimit. Përbërja e komisionit formohet dhe miratohet nga Dekani (Evidencë R.2.b). Pas mbrojtjes së Temës së Diplomes pajiset me diplomën.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Stafi akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për t'u njohur me opsionet e procedurat që duhet të ndjekin gjatë realizimit të temës së diplomës, rregullat dhe përgjegjësitë e palëve, problematikat me plagjiaturën etj, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me metodologjinë e përdorur.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Ajo që konstatohet është se institucioni vendos të gjithë infrastrukturën e tij akademike, dhe administrative në ndihmë të realizimit me sukses të këtij procesi. Institucioni ndihmon gjithashtu studentët në rastet kur ka nevojshmëri për realizimin e kërkimeve të studentëve në institucione jashtë strukturave të AU.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar RVB-së, Udhëheqësi shkencor ndjek dhe kontrollon me përgjegjësi përcaktimin e metodologjisë së punimit, nxjerrjen e rezultateve, diskutimin e tyre dhe konkluzionet. Kontrolli i punës së studentit bëhet në mënyrë periodike, (3 kontrole) dhe në përfundim të punimit, nëse udhëheqësi është dakord me punimin e realizuar, firmos deklaratën e Diplomës, (Evidencë 3.9) e cila është dokumenti që depozitohet në Departament dhe që konfirmon paraqitjen e punimit të diplomës përpara Komisionit të Diplomimit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë</p>	<p>Referuar RVB-së, në përfundim të mbrojtjes së Diplomës përpara Komisionit, studentit vlerësohet me notë, e cila është reflektim i punës kërkimore shkencore të studentit sipas parametrave të studimeve shkencore dhe aftësive mbrojtëse të</p>

P. P. P. P.
Belmolle

	temës përpara komisionit. Nota e diplomimit plotësohet në procesverbalet e diplomimit dhe depozitohet në sekretari.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listë notash dhe suplementin e diplomës. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që e shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin me të cilin programi ka marrë vendimin për riorganizim të tij nga MASR. (Evidencë 2.3).			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të syllabuseve të këtij programi studimi në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur. (Evidencës 3.17)			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen	Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit për periudhë të pacaktuar dhe mund të vë në dispozicion informacion për të nëse kërkohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

P. P. P.
Pelmo

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në organigramën e Albanian University, lista e stafit akademik në fakultet (statistika), lista e personelit akademik për programin e studimit Stomatologji (personeli akademik i programit), janë paraqitur të dhëna për stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p>Programi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Stomatologjisë. Njësia Bazë ka Përgjegjësin e Departamentit, programi koordinohet nga një koordinator si dhe ka një Asistent departamenti.</p> <p>Fakulteti ruan të dhëna për stafin e angazhuar në programet që oforn Departamenti i Stomatologjisë, të cilat të dhëna përditësohen çdo vit akademik duke përfshirë anëtarët e personelit akademik në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. Në takimin tonë me zyrën e burimeve njerëzore vërtetuam se para fillimit të çdo viti akademik apo semestri dhe në mënyrë të vazhdueshme në varësi të aktivitetit që ka stafi, të dhënat gjinden në këtë zyrë. (vizita në zyrën e burimeve njerëzore).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me administratën e Universitetit dhe Fakultetit, nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore dhe nga shqyrtimi i evidencës (Punësimi i personelit akademik efektiv);(Punësimi i stafit akademik PAK), pamë se procedurat zhvillohen në përputhje me kriteret ligjore në fuqi për rekrutimin e personelit akademik. Procesi zhvillohet çdo vit akademik i koordinuar nga fakulteti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e posaçme për rekrutimin e personelit (procedurë rekrutimi) përcaktohen nga departamentet dhe fakulteti në bazë të nevojave që vet fakulteti ka për punësimin e stafit akademik, të cilat më pas i përcillen zyrës së burimeve njerëzore me ç’rast bën shpalljen e tyre në web faqe. Sipas kriterëve të konkursit, procedura e rekrutimit bëhet duke u dhënë përparësi kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës. Dekanati i Fakultetit ngre Komisionin ad-hoc të Vlerësimit, të posaçëm për vlerësim. Komisioni mbasi merr në dorëzim dokumentacionin</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë</p>	

<p>përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>e kandidaturave për vendet përkatëse vakante, shpall procedurën e zhvillimit të intervistave. Kandidatët njoftohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore për datën e zhvillimit të intervistave. Vendimi i përzgjedhjes së kandidatëve i dërgohet Rektorit, Administratores, Departamenteve përkatëse, Zyrës së Kurrikulës, Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Informacioni i dhënë në takimin me administratën dhe në RVB (faqe 48- 49), mendojmë se është i plotë dhe evidentohet që institucioni i ndjek procedurat standarte të rekrutimit.</p> <p>Sipas deklarimeve të përfaqësuesëve të fakultetit, në rinovimin e kontratës, merren parasysh vlerësimet gjatë vitit nga departamentet dhe vlerësimi nga studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Në takim me personelin, ata u shprehën se për realizimin e programit të studimit është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme në fakultet si dhe infrastruktura universitare shëndetësore dhe laboratorike dhe duke i dhënë kështu mundësinë e barabartë personelit akademik në kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre. Gjatë vizitës dy ditore, GVJ vizitoi mjediset e punës praktike të studentëve. U konkludua se Rregullorja e AU, përcakton se insitucioni angazhohet në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune për stafin akademik, plotësohet.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka marrë të drejtën nga QKEV të akreditojë konferencat e veta në fushën mjekësore, njësi kjo që kanë si qëllim formimin e vazhduar. Referuar evidencave të paraqitura, gjatë vitit akademik mundësohet ofrimi i leksioneve të hapura me lektorë të huaj, mobiliteti në kuadër të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton gjithashtu, se trajnimet e stafit akademik përbëjnë një pjesë integrale të Planit të Zhvillimit Strategjik të “Albanian University”.</p>

P. P. P. P.

P. P. P. P.

inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.	Evidentohet se NJSBC në bashkëpunim me njësitë e tjera të institucionit organizon trajnime të stafit me fokus specifik, për të përmirësuar zhvillimin profesional. Trajnimet zhvillohen nga trajnues vendas dhe të huaj me qëllim ndërkombëtarizimin e AU. (Evidence 1.5- STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONIT)			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve	Bazuar në organogramën në AU, rezulton se fakulteti është një strukturë lehtësisht e menaxhueshme. Zyra e burimeve njerëzore disponon listën e personelit akademik të programit të studimit dhe atij mbështetes dhe rezulton se fakulteti disponon burimet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të programit të studimit. GVJ konkludon se stafi i programit të studimit është në përputhje me fushën e ekspertizës. Zhvillimi i profilit didaktik të stafit të fakultetit kryhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet ofrimit të leksioneve të hapura me lektorë të huaj, ofrimin e trajnimeve lidhur me metodat inovative në specialitet përkatëse, programet e mobilitetit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, pjesmarrje në aktivitete shkencore të përbashkëta, trajnime kualifikuese etj. Fakulteti për përdorimin me lehtësi të platformave të ndryshme ka kryer trajnime dhe ka vënë në dispozicion manualet dhe rregulloret të ndryshme për personelin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	Bazuar në RVB (faqe 51-52), janë paraqitur informacione të detajuara mbi kapacitetet që ka fakulteti dhe universiteti. Edhe në evidencën e Infrastrukturës rezulton se mjediset në dispozicion të programit, të ofruara nga fakulteti janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvatje të procesit mësimor.

P. Puljica

Prof. molle

<p>studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Grupi i vlerësimit vlerëson infrastrukturën klinike stomatologjike, e cila është e akredituar nga MAS, mjaft të rëndësishme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe profesionale për këtë program studimi. Studentët e Programit të studimit, realizojnë mësimin në përgjithësi paradite në orar të përshtatshëm që u krijon mundësi studentëve për të shfrytëzuar maksimalisht kohën për të studiuar apo punuar në bibliotekë. Ky orar është mjaft i përshtatshëm veçanërisht për studentët që realizojnë praktikat me pacientë realë. Sipërfaqja në dispozicion të procesit mësimor në godinën e Fakultetit është rreth 2067,4 m² e cila në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, natyrën specifike të lëndëve përkatëse shfrytëzohet në kapacitet të plotë. Fakulteti përdor gjithashtu sallat dhe mjediset e tjera në Godinën e ish Internacionalit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Fakulteti vë në dispozicion infrastrukturë të mjaftueshme për proceset akademike si: godina e ish Gjykatës, godina e ish Internacionalit për lëndët paraklinike, godina e Estradës. Mjediset në dispozicion të programit, të ofruara nga universiteti dhe fakulteti janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvatje të procesit mësimor. Nga vizita që GVJ realizoi në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore rezultoi se insitucioni disponon ambiente me ndriçim natyral dhe të pajisura me projektorë, kompjutorë. Në vizitën dyditore dhe bazuar në RVB, shihet se Fakulteti disponon 9 laboratorë për realizimin e laboratorëve dhe praktikave lëndore. (fq.51 RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Këto laboratorë janë të pajisur mirë me mjetet e domosdoshme për studentët për realizimin me sukses të punëve laboratorike, gjithashtu sallat e leksiove dhe seminareve janë të përshtatura për realizimin teorik dhe praktik të mësimdhënies. Realizimi i praktikave profesionale për studentët realizohet në Klinikën Stomatologjike Universitare, me vendndodhje në godinën e Ish-Gjykatës, e cila është e organizuar në salla sipas specialiteteve të ndryshme. GVJ gjatë vizitës në ambiente vlerësoi kapacitetin e klinikës si të përshtatshëm për numrin e studentëve të programit të studimit dhe plotëson plotësisht kërkesat specifike të tij.</p>

P. P. P.

P. P. P.

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe sipas gjetjeve gjatë vizitës në terren, rezulton se në godinën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore ekziston një laborator i Informatikës, i pajisur me aparaturat e teknologjisë së informacionit dhe programet e nevojshme për funksionimin e tyre, i cili vihet në dispozicion të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Klinika Stomatologjike Universitare disponojnë mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ identifikoi se AU ka tri biblioteka. Fondi i bibliotekës mbulon kryesisht fushat e shkencave mjekësore, stomatologjike, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Gjithashtu, kjo bibliotekë ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka është vënë në dispozicion të studentëve me 144 tituj në gjuhën shqipe dhe angleze vetëm për këtë program studimi. Gjithashtu, rezultoi se studentët kanë mundësi të gjëjnë në bibliotekën e AU literaturën që pedagogët kanë përcaktuar në syllabsin e lëndëve. Tekstet e përkthyer janë literaturë amerikane, Elsevier, përkthyer nga UFO-Press. (RVB- faqe 52). Literatura e ofruar si në formë hardcopy, në format elektronik dhe online mundësojnë</p>

P. P. P. P.

<p>mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>realizimin me sukses të projekteve kërkimore-shkencore të moduleve e veprimtarive mësimore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>AU ka vënë dispozicion të studentëve një sërë librarish online të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës në qendrën e internetit. Gjithashtu, u evidentua që biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për të aksesuar në bibliotekat online që AU disponon. Biblioteka disponon dhe materiale online EBSCO HOST (RVB faqe 53). Të gjitha këto vihen në dispozicion të studentëve pa pagesa shtesë.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Ambientet e bibliotekës së FSHM disponojnë një numër prej 20 njësisish kompjuterike, të cilat janë në dispozicion të studentëve. Në bibliotekën e fakultetit janë vënë në dispozicion të studentëve të programi të studimit 35 poste leximi. Bazuar në takimin me studentët në përgjithësi literatura e lëndëve është në shqip.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>AU çdo vit planifikon fond të veçantë për blerjen e literaturës së detyrueshme për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor. Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamenti bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër. Bibliotekat e institucionit, përveç botimeve të reja që shtohen vazhdimisht, pasurohen me dizertacionet, botimet shkencore dhe tekstet mësimore të personelit akademik të institucionit.(RVB fq 54)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 — 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 — 12.00. Këto orare janë të shpallura në mjediset e fakultetit. Studentët kanë kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës. Shërbimi i bibliotekës realizohet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët, të cilët regjistrohen përmes kartës së regjistrimit dhe mund të aksesojnë literaturë si në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhë të huaj në ambientet e bibliotekës. Salla e bibliotekës disponon një numër tavolinash dhe kënd leximi, me një hapësirë që plotëson kërkesat e studentëve. Në takim me administratën, u vu re se</p>

P. P. P. P.
Deluola

	Fakulteti ka vënë në dispozicion të bibliotekës një person i cili administron bibliotekën dhe është në dispozicion të kërkesave të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion pranë sekretarisë mësimore, GVJ konstaton se Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe azhornimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Albanian University ka marrëveshje bashkëpunimi me Rrjetin Akademik Shqiptar, Pitagora, nëpërmjet të cilit përfitohen shërbime në fushën e Teknologjisë së Informacionit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Bazuar në RVB (faqe 55), rezulton se Albanian University ka mundur aksesin e të gjithë personelit të saj drejtues, akademik, administrativ dhe komunitetit studentor në platformën Microsoft Teams. Kjo platformë ka bërë të mundur komunikimin e shpejtë dhe në kohë reale midis personelit akademik dhe studentëve, nëpërmjet hapjes së adresave institucionale për të gjithë komunitetin e Albanian University.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Gjithashtu, informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik ruhen në Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në realizimin e programit ruhen në Departament dhe në zyrat përkatëse: Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e koordinimit të Kërkimit dhe Botimeve Akadematike etj. në funksion të fushës së bashkëpunimit. Dokumentacioni i stafit akademik dhe i
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>studentëve është lehtësisht i aksesueshëm nga sistemi i brendshëm i institucionit.</p> <p>Në FSHM, sipas deklarimeve ofrohen dhe shërbime të tjera si provimi i licencimit realizuar pranë ambjenteve nga Urdhëri i Stomatologut, testimi i kandidatëve për programet e ciklit të tretë të studimit specializime afatgjata. Bazuar edhe në vlerësimin e stafit dhe studentëve, GVJ e vlerëson të përshtatshme përdorimin e sistemeve të menaxhimit në FSHM.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Fakulteti ka dy faqe interneti (RVB – faqe 55) por aksesimi i disa informacioneve gjatë hulumtimit nuk ishte i mundur. Faqja e fakultetit përmban informacione të limituara në gjuhën angleze dhe pavarësisht se informacionet kryesore në gjuhën angleze publikohen në faqen zyrtare të universitetit, <i>GVJ rekomandon të përditësohet faqja e fakultetit me informacionet e duhura.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB, vëhet re se si institucion universitar privat AU, funksionon në bazë të parimit të autonomisë financiare sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015. AU si pjesë e Shoqërisë UFO shpk, i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat, bazuar në programin financiar afatmesëm tre vjeçar.</p> <p>Institucioni ka paraqitur evidenca lidhur me aktivitetin financiar. Nga vizita dy ditore dhe nga dokumentacioni në dispozicion, u konstatua se Institucioni harton raportin e bilancit të të gjithë shoqërisë çdo vit, ku parashihen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat. Ky raport disponohet nga zyra e financave të universitetit. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e</p>	

P. P. P.
P. P. P.

<p>mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>hartuar dhe çertifikuar nga ekspertë të jashtëm (raportet vjetore), (hartimi i buxhetit). Ky plan ka të detajuar në brendësi të tij të gjitha zërat e nevojshëm për realizimin e programit të studimit, duke filluar nga mjediset për realizimin e programit, materialet e nevojshme, si projektorë, kompjutorë, libra etj. Raportet vjetore përmbajnë informacione financiare mbi të ardhurat të ndara në zëra të caktuar. Fakulteti ka administratorin e vet ndërsa aktiviteti financiar zhvillohet në bashkëpunim me Administratorin e Universitetit dhe Bordin e Administrimit. GVJ konstatoi një organizim dhe mbajtje të rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar VB-së, Institucioni bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, i cili bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik. Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Financave, dokumenton raportet financiare pas çdo cikli studimi, duke planifikuar ndërhyrje të mundshme për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. (RVB fq.57)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Zyrës të Financave, dokumenton raportet financiare pas çdo cikli studimi, duke planifikuar ndërhyrje të mundshme për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. (RVB fq.57)</p>

P. P. P.
P. P. P.

situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e insitucionit, rezulton se AU ka praktika të cilat përfshijnë ciklin e plotë 5 vjeçar të studentëve nga pranimi i tyre e deri në diplomim. Kriteret dhe procedurat e programit përcaktohen në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015. Kriter përcaktues për studentët që duan të studiojnë në programin e studimit Msc Stomatologji përcaktohen çdo vit nga fakulteti dhe Senati Akademik (Kriteret e Pranimit në Programin e Studimit).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të	Në rregulloren e sekretarisë mësimore dhe takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore, rezulton se regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë

P. Mulla
Belinda

<p>mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>të sanksionuara në aktet e institucionit. Procedurat janë të miratuara e të bëra publike në web faqe. (faqja zyrtare, Kriteret e Pranimit – ALBANIAN UNIVERSITY). Pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi, mbi rregulloren e programit dhe rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve. Kandidati për ndjekjen e programit Master i Shkencave në Stomatologji, paraqitet personalisht pranë sekretarisë mësimore, ku plotëson formularin e aplikimit për këtë program si dhe paraqet dokumentacionin përkatës. Procesi i seleksionimit organizohet dhe drejtohet sipas rregullore së organizimit të programit, rregullore së regjistrimeve dhe transferimeve dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Me qëllim që maturantët të njihen paraprakisht me kriteret e pranimit dhe t’iu ipet mundësia për tu regjistruar, bëhet publikimi i kritereve nga ana e institucionit dhe atë një vit në avancë. Referuar Rregullore së programit të studimit, takimit me studentët dhe evidencës, Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programin e integruar të studimit Master i Shkencave në “Stomatologji” të ofruara nga Departamenti i Stomatologjisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mesatarja e përgjithshme 70%; - Mesatarja e gruplëndëve 30%,(Kimi 10%, Biologji. 15%, Gjuhë e huaj 5%.);
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Studentët deklaruan se informohen në fillim të çdo viti akademik në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe studentët rezultoi se Fakulteti në bashkëpunim me Këshillin Studentor organizon aktivitete informuese për maturantët e shkollave jo vetëm të Tiranës, por edhe të rretheve të tjera. Në këto aktivitete bëhet një prezantim i programit të studimit si dhe i ambienteve të fakultetit, ku maturantëve iu jepet mundësia që të kalojnë një ditë pranë studentëve të vitit të 5-të, kryesisht për tu njohur më nga afër me atë çka ofron AU. Informacion i plotë informues paraqitet edhe ne manualin e studentit.</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Si institucion privat dhe në mbështetje të politikave sociale për kategori të ndryshme maturantësh, AU alokon kuota të veçanta dhe kriteret përzgjedhëse specifike për këto kategori (Statuti). Nga takimi me studentët GVJ u informua se një pjesë të kutoave për programin e studimit i ve në dispozicion të studentëve nga trojet shqiptare dhe komuniteteve, por edhe për studentë të huaj. Gjithashtu ofrohen bursa për Programin e Ekselencës; Bursa për pjesëtarë të së njëjtës familje; Bursa për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës. Bazuar në deklaratimet e Dekanit të Fakultetit dhe Drejtueses së Departamentit të programit, synohet hapja e programit për studentët e huaj në bashkëpunim me universitet italiane.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Fakulteti ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me njërin prind invalid. Fakulteti ka parashikuar kuota pranimit në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100% . (mbështetja ndaj studentëve). Kriteri kryesor për studentët që të mbështeten me bursë është mesatarja.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë</p>	<p>Fakulteti ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me njërin prind invalid. Fakulteti ka parashikuar kuota pranimit në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100% . (mbështetja ndaj studentëve). Kriteri kryesor për studentët që të mbështeten me bursë është mesatarja.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet Pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se Institucioni që në regjistrim informon studentët me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Gjithashtu edhe organizimi i studentëve në Këshillin studentor të fakultetit, senatorët në çdo grup, mundëson informim të shpejtë të tyre. Me anë të këshillit studentor, studentët informohen në lidhje me procesin e tyre mësimor dhe procedurat e caktuara. Për kalimin nga një vit në vitin tjetër studentët duhet të grumbullojnë 30 kredi/ 30 ECTS.</p>

P. P. P.
P. P. P.

	(Rregullorja e programit)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e programit të studimit si dhe nga bashkëbisedimi me studentët, rezulton se AU ka të përcaktura qartë procedurat dhe kriteret për studentët, të cilët duan të transferojnë studimet e tyre, apo për ata studentë të cilët kanë qënë pjesë e kualifikimeve të pjesshme.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në dokumentin (Manual i Studentëve), si dhe takimin që GVJ pati me stafin akademik, rezulton se në orën e parë të fillimit të semestrit, studentët njihen me syllabusin e lëndës nga pedagogu përkatës, i cili u shpjegon mënyrën e vlerësimit, aftësitë dhe njohuritë që ata do të përfitojnë në fund të lëndës si dhe frekuentimin e saj. Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregulloren e Programit të studimit e dhënë si evidencë, rezulton se studentët e programit të integruar të studimit Msc Stomatologji, diplomohen me Temë Diplome. Procedura, që duhet të ndjek studentin për diplomën me Temë Diplome është e detajuar, ndërkohë informacioni i nevojshëm mund të merret po ashtu nga koordinatori i programit, dhe udhëheqësi i temës së diplomës.(Evidenca 2.13)

P. P. P. P.
P. P. P. P.

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Albanian University harton dhe publikon Manifestin Akademik. Studentët informohen mbi programin e studimit edhe me anë të rrjeteve sociale, manualin e studentit si dhe me anë të faqes zyrtare të AU. Gjithashtu bazuar në evidencën (Aktivitete të Këshillit Studentor), AU mbështet Këshillin Studentor në organizimin e takimeve informuese për maturanët, të cilët duan të bëhen pjesë programit të studimit. Gjithashtu, institucioni nëpërmjet zyrës përkatëse por edhe instancat e tjera specifiku Departamenti, informojnë kandidatët e interesuar për programin e studimit, duke ju dhënë të gjithë informacionin mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to, stafin akademik të angazhuar në secilin program studimi, detyrimet akademike për studentin e deri në finalizimin e studimeve master. Përfaqësues të fakultetit organizojnë takime me maturantë për promovimin e programeve të studimit që fakulteti ofron.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet Pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitën në institucion, GVJ vlerëson se studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët [ZKMS] janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj. Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, me organizimin e lëndës në leksione/ seminare/</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>ushtrime/ detyra kursi, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. Nga takimi me studentët u kuptua se studentët në fillim të çdo viti akademik marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me kohëzgjatjen e programit të studimit, mënyrën e vlerësimit të njohurive, planin mësimor, si dhe literaturën që do ti duhet përtë shqyrtuar çdo lëndë, e cila është e parashikuar në Syllabus të asaj lënde. (Aneksi 1.6 plani mësimor)</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit, në sekretarinë online dhe në faqen e tij web të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Dokumentacioni i programit përmban informacion mbi mundësitë e punësimit. FSHM në bazë të marrëveshjeve të lidhura me insitucionet kombëtare dhe ndërkombetare si dhe me klinikat private i krijon mundësinë studentëve që pas përfundimit të ciklit të studimit të punësohen në disa prej tyre. (Marrëveshjet)</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Referuar takimit me studentët, rezulton se studentët janë të informuar mbi infrastrukturën e fakultetit dhe ambientet ku do të realizohet procesi mësimor dhe praktikat profesionale. Platforma GRADUA ju vjen në ndihmë studentëve duke i krijuar një urë lidhëse me tregun e punës. Falë regjistrimit në platformën GRADUA, studentët mund të krijojnë CV-në e tyre personale, të kenë qasje të lehtë në informacion mbi mundësitë e punësimit/ praktikës profesionale. Komunikimi zyrtar realizohet nëpërmjet adresave zyrtare të institucionit, çka e lehtëson këtë komunikim. Institucioni ka një sistem informacioni të efektshëm për ruajtjen e informacioneve personale të studentëve nga sekretaritë mësimore dhe kryesekretaret, sikurse disponon edhe sistemin kombëtar të shërbimit RASH.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>				
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet Pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Paulina
Paulina

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se institucioni disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar në programe. Sekretaria mësimore e programit të studimit, kryesekretaria e Fakultetit si dhe Administratori i përgjithshëm menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. U evidentua se sekretaria mësimore disponon statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar ndër vite. Sekretaria mësimore, ruan evidencat dhe dosjet e plota të çdo studenti, kjo u evidentua dhe në takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore. Në statistikën e vëna në dispozicion të GVJ, është kryer edhe analiza mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe ecuria e tyre gjatë studimeve. AU është pjesë e projektit GRADUA i cili në thelb ka të bëjë me krijimin e bazës së të dhënave të studentëve të diplomuar në hapësirën europiane. (Projekti Gradua)
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Nga takimi që GVJ realizoi me sekretarinë mësimore evidentoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbarëvajtjen e të dhënave të ecurisë së studentëve në programin e studimit, me anë të regjistrave të notave dhe të frekuentimit, regjistrin të gjeneraliteteve, dosjeve të studentëve, përgjatë 5 viteve të ciklit



<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>të studimit. (rregullorja e sekretarisë), (vizita në mjediset e fakultetit). Dosjet e studentëve ruhen në sekretarinë mësimore. Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në regjistrin hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Sipas (Evidences 2.10) dhe vizitës në institucionin numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për një cikël të plotë studimi rezulton:</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni në mënyrë periodike harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e punësimit të studentëve. Në rastet kur vihen re problematika lidhur me këto tregues, ndërmerren masa për përmirësimin e tyre. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim me kërkesë të saj. (Evidenca 5.5, nenet 2, 3 dhe 4).</p> <p>Çdo përfundim të semestrit Kryesekretari paraqet pranë Dekanit të Fakultetit dhe Rektorit një raport të veçantë me të dhëna të detajuara mbi realizimin e detyrave dhe të situatës në përgjithësi. Në evidencën (Raporti vjetor Dekan FSHM), rezulton se AU bën analiza dhe raporte mbi ecurinë e studentëve si dhe i njeh ata me mundësitë e punësimit, sic rezultoi dhe nga takimet që GVJ realizoi në institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmirësimit të standardit</p>	<p>Nuk përmirësohet</p>	<p>Përmirësohet pjesërisht</p>	<p>Përmirësohet kryesisht</p>	<p>Përmirësohet plotësisht</p>
				<p>X</p>

P. P. P. P.
P. P. P. P.

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në statutin dhe Rregulloren e AU rezulton se studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të Universitetit, siç janë Senati Akademik, Këshillat studentore dhe komisionet të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi. Pjesë e grupit të vlerësimit të këtij programi ka qënë gjithashtu një përfaqësues i studentëve. (GVB). Ata, gjithashtu, shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në takimin me studentët dhe shqyrtimi i evidencave; Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të AU”, rezulton se studentët janë pjesë aktive dhe e rëndësishme e organeve përfaqësuese dhe administrative. Siç u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbështetje të vazhdueshme nga stafi akademik dhe administrativ, për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë. Në mënyrë periodike, në bashkëpunim me fakultetin dhe struktura të tjera të AU, kryhen aktivitete në vit, duke nisur nga Konferencat Kombëtare të Stomatologjisë ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, pjesëmarrje në Shkollat Verore e Dimërore Mjekësore apo trajnimet me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit Studentët japin mendime për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifatat e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikatat, sezonet e provimeve etj.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas (nenit 25 të Statutit) “Komisionet e përhershme”, studentët kanë përfaqësimin e tyre në për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Në këtë mënyrë me anë të mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, ata bëhen pjesë e vendimmarrjeve në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Institucioni në vazhdimësi është i</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Sipas (nenit 25 të Statutit) “Komisionet e përhershme”, studentët kanë përfaqësimin e tyre në për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Në këtë mënyrë me anë të mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, ata bëhen pjesë e vendimmarrjeve në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Institucioni në vazhdimësi është i</p>

		hapur dhe me vëmendje të veçantë për propozimet e studentëve.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.		GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lart, Dekani i Fakultetit përkatës ngrë një komision ad hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korigjuar provimet.(Aneksi 1.4)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Në takimin me stafin akademik rezultoi se personeli angazhohet dhe merr pjesë në Konferenca, Workshope dhe kongrese ku mund të përmendim Konferencën Ndërkombëtare të Stomatologjisë, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore/AU, Kongresin Ballkanik të Shoqatës së Stomatologëve, etj. (aktiviteti kërkimor), (raportet vjetore) madje, ekzistenca e mundësisë për vetëakreditim të aktiviteteve shkencore në AU është një tregues për cilësinë e këtyre aktiviteteve. (evidencë miratimi QKEV-së për vetëakreditim) GVJ vlerëson impaktin e kërkimit shkencor dhe kontributin që jep AU si strukturë private në zhvillimin e stomatologjisë në Shqipëri.

P. P. P.
P. P. P.

<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>FSHM në funksion të programit të studimit ka lidhur një sërë marrëveshjesh ndër të cilat janë edhe ato me insitucione të tjera të arsimit të lartë sic është marrëveshja e lidhur me Universitetin prestigjioz të Ferrarës, Itali për programe të përbashkëta studimi në kuadër te nderkombetarizimit (Lista e Marrëveshjeve Ndërkombëtare). Bazuar në numrin e madh të bashkëpunimeve, GVJ vlerëson si pozitivisht përpjekjet e institucionit për të bashkëpunuar me organizma dhe institucione brenda dhe jashtë vendit në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe mobilitetit.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Bazuar në takimet me studentët dhe në evidencat e paraqitura si, (Aktivitete me Studente dhe Brainstorm; Prezantime studentesh ne konferenca), Kongresi i 8 Botëror Virtual i Studentëve Dentarë – organizuar nga European Dental Students Association (EDSA), 20-22 Maj 2020, në Zagreb, rezulton se studentët janë të mbeshtetur të nxitur dhe të motivuar nga stafi akademik për të publikuar apo referuar punët e tyre kërkimore / shkencore.</p> <p>Studentët janë motivuar të marrin pjesë me publikime në Konferencën Kombëtare e Ndërkombëtare të Shkencave Mjekësore, etj. Sa i përket stafit akademik nga takimi me Dekanen e FSHM, Drejtuesen e Departamentit dhe Personelin Akademik, GVJ u informua se personeli akademik mbeshtetet në infrastukturën didaktike të AU për punimet e tyre kërkimore shkencore dhe më pas publikimin në revista me</p>

P. P. P. P. *P. P. P. P.*

<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>faktor impakti. (evidenca kërkimit shkencor). Në takim me studentët u pohua se ata marrin pjesë në kërkime shkencore dhe kjo u vlerësua pozitivisht nga ana e GVJ. Ndër punimet e publikuara nga stafi akademik, që mund të veçohen, janë me sa vijon: Oral Microflora, in Cases with Gingival Hypertrophy Caused by Fixed Orthodontic Appliances SpringerLink https://publications.waset.org/10012618/comparison-between-different-classifications-of-periodontal-diseases-and-their-advantages https://www.ijpi.in/article-details/13628 (99+) Trauma From Occlusion And Its Radiographic Detection Redjon Isai - Academia.edu <i>Megjithatë, GVJ rekomandon stafin udhëheqës, që këto kërkime shkencore të stafit akademik dhe studentëve të vazhdohet të publikohen në revista shkencore të indeksuara në platforma, si: Web of Science, Scopus, Pubmed.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Stafi akademik rezulton se inkurajon gjithashtu studentët e masterit shkencor të marrin pjesë në konferenca shkencore. Në të dhënat për veprimtaritë kërkimore, ka të dhëna se organizimi kalon përmes filtrave shkencor. Studentët motivohen të përdorin metoda, të cilat do tju jepnin mundësi atyre të jenë më afër realitetit dhe nismave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të përdorimit të teknologjive të inovacionit. Stafi është i përfshirë në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me tezat e diplomave. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët të cilët kanë në udhëheqje duke vlerësuar performancën dhe progresin e tyre. Pedagogu udhëheqës gjithashtu orienton studentin për prezantimin para komisionit të mbrojtjes dhe në varësi të cilësisë së punimit, ato vendosen që të procedohen për publikohen në revistën Optime. https://doi.org/10.55312/op.v12i1-2.172 https://doi.org/10.55312/op.v12i1-2.51 View of Herbalizmi dentar (albanica.al)</p>

Publika
Definita

Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Studentët inkurajohen nga stafi akademik, të përdorin dhe aplikojnë metoda dhe metodologji inovative, të cilat do tju jepnin mundësi atyre të jenë më afër realitetit dhe nismave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të përdorimit të teknologjive të inovacionit. Stafi akademik i fakultetit është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me tezat. Synimi i fakultetit për zhvillimin e temave dhe punimeve cilësore është deklaruar dhe mbështetur nga stafi dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet Pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit	Nga marrëveshjet e përmendura në kuadër të mobilitetit dhe bashkëpunimit të stafit për kërkim shkencor, është mundësuar ngritja e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të personelit akademik dhe fakultetit në tërësi. Disa pedagogë kanë zhvilluar vizita studimore, në institucione partnere (Evidenca 1.23/ Raporti analitik mbi përfitimin e marrëveshjeve) duke përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe projektet. AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit.
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Mbështetja e studentëve përmes bashkëpunimeve mundëson krijimin e lidhjeve për shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve. Këto bashkëpunime kanë sjellë përmirësim të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit i cili na përmbajtjen aktuale përputhet me mjaft programe që zhvillohet në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. (Evidenca 3.11)
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.	Në RVB dhe takimin që GVJ realizoi me stafin akademik, Dekanin, Drejtuesin e Departamentit u informuam se, politikat e kërkimit të institucionit janë konceptuar, për të

<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>qenë gjithëpërfshirëse dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e studiuesve të rinjë (strategjia e kërkimit shkencor). Kjo formë bashkëpunimi ka favorizuar angazhimin e personelit të ri në aktivitete kërkimore si dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në studime, dhe në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. Janë ftuar lektorë të huaj të cilët zhvillojnë takime dhe leksione të hapura (lektorët e huaj).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Konceptimi dhe ndërtimi i kurrikulës së programit të integruar të studimit është realizuar me synimin për të përgatitur studentë me kompetenca dhe aftësi për tu adaptuar në tregun e punës po aq sa edhe për të qenë pjesë e studimeve të mëtejshme. (programi, plani mësimor). Në programin e studimit janë përfshirë lëndë me karakter formues, analitik dhe profesional. Kjo u krijon atyre mundësinë të kenë njohuri të duhura në dimensione të ndryshme profesionale por edhe të kenë aftësi për të përdorur metoda dhe teknika të reja që zbatohen aktualisht në institucionet partnere. Nga takimi i GVJ u konkludua se studentët janë aktivë dhe përfshihen në veprimtari ndërkombëtare e që poashtu identifikohet përmes manualit të studentëve, aktiviteteve të studentëve dhe nga prezantimet e tyre.</p>			
<p>kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>AU fton herë pas here personazhe të njohura të fushës së Stomatologjisë për të organizuar orë të leksione , seminare apo orë të hapura me studentët, ku mund të përmëndim profesorë të ardhur nga Universiteti i Napolit, “La sapienza” Romë, Pisa, Biruni etj. Në takimin me Dekanin e Fakultetit u deklarua se ndërkombëtarizimi i programit të studimit do të vazhdojë të rrisë impaktin e vet në rajon e më gjerë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet Pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

Prof. Dr. ...
Def. ...

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Referuar statutit dhe rregullores së AU rezulton se FSHM, Departamenti i Stomatologjisë disponon strukturat e nevojshme informuese për studentët sic janë, “Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit, “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët” “Zyra e Karrierës dhe Alumnit” Sekretaria mësimore. Kjo zyrë mirëpret, informon dhe orienton studentët në lidhje me aspekte të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Nga ana tjetër kjo zyrë merr përsipër të njoftojë dhe ndjekë studentët në lidhje me aktivitete me karakter shkencor apo trajnimi për adaptimin e njohurive të tyre. Zyra siguron mundësi të ndryshme trajnimi, mobiliteti, projektesh dhe bashkëpunon ngushtë me këshillat studentorë. Në vitin e kaluar, aktivitetit të kësaj zyre i është shtuar edhe databaza e të diplomuarve nga zbatimi i projektit Gradua. (projekti gradua) Të dhënat e gjeneruara ndihmojnë studentët për punësim dhe ndihmojnë fakultetin të mbajë kontakte të vazhdueshme dhe të ndjekë historikun e punësimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e studentëve nga Departamenti, dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve ku informojnë studentët përgjatë kohëzgjatjes së studimeve dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni. Paralelisht me GRADUA, Sekretaria mësimore mban të dhëna dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë ciklit të tyre të studimit, po ashtu në të njëjtën linjë vepron edhe zyra e këshillimit dhe orientimit të studentëve, duke i ndihmuar ata në zgjedhjet që kanë të bëjnë direkt me programin e studimit siç janë përzgjedhja e institucioneve për kryerjen e praktikës profesionale asistimi në mënyrat e të qasurit drejt tregut të punësm trajnimeve të ndryshme etj. Bashkëpunimi me Urdhërin e Stomatologut i mundëson Fakultetit databazë me të dhëna të studentëve tashmë të diplomuar dhe të punësuar në nivel kombëtar (faqja e urdhërit).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sekretaria mban kontakte me studentët e diplomuar dhe bashkëpunojnë në aktivitete të ndryshme. Për tu ardhur në ndihmë studentëve të rinjë, FSHM çdo vit përditëson dhe publikon Manualin e studentit, i cili përmban mjaft informacione të vlefshme për AU, programet, infrastrukturën,</p>

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>personelin akademik, jetën studentore dhe mjaft informacione të vlefshme për studentët dhe përfshirjen e tyre në jetën e fakultetit. Në nivel të Universitetit funksionon Zyra e Karrierës, e cila ka funksionale një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Rol kryesor në këtë drejtim luan koordinatori i programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet Pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet Pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme përsigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar Statutit të Institucionit AU, në zbatim të Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë në Shqipëri, AU ka ngritur me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional. Kjo strukturë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë në gjithë programet e studimit të AU dhe cilësinë në universitet. Ajo monitoron dhe garanton realizimin e procesve të ndryshme akademike në AU (Rregullore NJSBC).</p>

P. P. P. P.

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sisteme Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Konstatohet se në “Albanian University”, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009 - 2010. Që nga ajo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ka ngritur me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në rregulloren e NJSBC, rezulton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse dhe bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për vlerësimin periodik të programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Pyetëtori për studentët si dhe anketimi i stafit akademik që realizohet në fund të çdo semestri është një nga instrumentet e përdorur për sigurimin e cilësisë. (Aneksi 6.10)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>AU në kuadër të sigurimit të cilësisë i kushton një rëndësi të vecantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore, me eksperiencë në fushën përkatëse. Trajnimi i stafit akademik është një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Zakonisht në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë tij, realizohen trajnime me personelin akademik, në disa raste edhe me lektorë të huaj, për çështje të tilla që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj. Instrumentat e shumta, si pyetësorët me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Gjithashtu, Institucioni në mënyrë periodike realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, si dhe merr të gjitha masat për të plotësuar maksimalisht rekomandimet e lëna nga vlerësuesit e jashtëm dhe Bordi i Akreditimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Vlen të theksohet si një element pozitiv që program i integruar i studimit MSc Stomatologji i cili është akredituar me kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare dhe është një program që i nënshtrohet riakreditimit periodik. Politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit paraqiten në strategjinë e zhvillimit institucional (Evidencë 1.5), si dhe në strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit. GVJ gjatë takimit me Sigurinë e Cilësisë pranë Departamentit gjeti pozitive përpjekjen e tyre për krijimin e kulturës së cilësisë. Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor i cili dërgohet në MAS, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen</p>

P. Mulla
P. Mulla

	e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën në bibliotekë.(Evidence 6.10); (Evidence 6.4)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të tënxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.	Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se “Albanian University”, përvec strukturave specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë ka ngritur edhe Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti. Këto grupe përbëhen nga staf akademik i brendshëm i Njesisë Bazë, konkretisht 2 apo 3 pedagogë me tituj e me grada, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve, në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, hartimin e raportit të vetëvlerësimit për programin e studimit, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura në evidenca si “Procedura për hapjen e nje programi të ri studimi apo ndryshim-rishikimin e një programi”, rezulton se institucioni përdor procedura formale e të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit. Madje gjatë takimit që GVJ pati me Dekanen dhe Drejtuesen e Departamentit rezultoi se kurrikula e përmirësuar deri në masën 20% kishte marrë aprovimin nga MAS për implementim në vitin e ri akademik.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdormetodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit tëstudimit.</p>	<p>Në RVB dhe nga takimet që GVJ realizoi me studentët dhe NJSBC rezulton se, Instrumentet e përdorura për vlerësimin e cilësisë përfshijnë anketimet dhe pyetësorët për studentët, Fokus grupe, formularin e vlerësimin të performancës së stafit akademik, inspektimet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, vlerësimin e detyravedhe provimeve të studentëve dhe kontrollin e plotësimin të ngarkesës mësimore dhe akademike.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dheu bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrësepër programin e studimit.</p>	<p>Në evidencën mbi Raportet Vjetore, rezulton se të gjitha rezultatet e mbledhura gjatë vitit akademik në kuadër të programit të studimit, janëpjesë e analizave vjetore të njësive bazë dhe kryesore të AU. Në raportin vjetor në nivel universiteti, NJSBC, si strukturë përgjegjëse, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin. Ky raport është subjekt i diskutimeve në mbledhjen e organeve kolegjiale të AU si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, ku evidentohet plani i masave me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit. (Plani i Zhvillimit Strategjik).</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimin duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimindhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimevetë mëtejshme të studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i integruar i studimit i nënshtrohet procesit të riakreditimit. AU si insitucion është akredituar në vitin 2017 nga me vendim të Bordit të Akreditimit. Nga shqyrtimi i Raporteve vjetore rezulton se NJSBC përfshin rezultate të vlerësimit në raportet vjetore të njëjësive kryesore dhe të institucionit, si dhe nëraporte të vlerësimit të brendshëm institucional të kryer në kuadër të akreditimit.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, përveç vlerësimeve në rang institucioni angazhohet në vlerësimin e programeve të studimit dhe ofertës akademike me metoda dhe instrumenta specifike të fushës. Në mënyrë të vazhduar, edhe si pjesë studimesh kërkimore - shkencore të stafit akademik. Departamenti i drejtohet studentëve për të marrë feedback për problematika të ndryshme, të cilat prekin drejtëpërsëdrejti programet e studimit të ofruara. Kjo realizohet mes kontakteve të drejtëpërdrejta të studentëve me Departamentin përmes emaileve apo takimeve ad-hoc në departament me drejtuesin për çështje specifike të mësimdhënies apo mësimnxënies. Në pyetësorët e studentëve dhe pyetësorët e performancës së stafit akademik, rezulton se AU përdor disa metoda për vlerësimin e programit të studimit ndër të cilat mund të përmëndim Vlerësime nga fokus grupe në diskutime me studentët, komisionet për vlerësimin</p>

Paulina
Belushi

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionete rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucionale apo Komisioni për Kurrikulat: monitorimi nga NJSBC në nivel institucional, monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit të studimit, vlerësime nga Dekani i fakultetit. Gjithashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e “Albanian University”. Referuar RVB, të dhëna nga Alumni japin një feedback për efikasitetin e programit të studimit dhe përshatshmërinë me tregun e punës. Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, është zhvilluar gjithashtu një pyetësor mbi “Lumturinë në punë” drejtuar stafit akademik dhe administrativ të Universitetit. FSHM bashkëpunon me Urdhërin e Stomatologut dhe ky lloj ndërveprimi është mjaft pozitiv jo vetëm për marrjen e informacioneve për rezultatet e të diplomuarve por mbi të gjitha për mendimet e idetë e profesionistëve për përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit. Studentët monitorohen gjatë ecurisë së tyre dhe bazuar në rezultatet e Provimit të shtetit të realizuar nga QSHA. Ky faktor shprehet gjithashtu edhe në nivelin e lartë të punësimit të të diplomuarve të Programit të Stomatologjisë sipas të dhënave që AU disponon dhe vë në dispozicion.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në takimin që GVJ pati me NJSBC, rezulton se anëtarët e kësaj njësie organizojnë takime me ekspertë huaj/të jashtëm për vlerësim të parametrave cilësorë. GVJ gjykon se institucioni ka përfshirë aktorë të jashtëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit, <i>por do të sugjeronte ndërlidhje kontraktuale të tyre që të mos mbetej në kuadër të takimeve sporadike.</i></p> <p>Bazuar dhe në kuadrin ligjor të vënë në dispozicion, GVJ identifikoi se institucioni garanton nëpërmjet politikave dhe procedurave të brendshme, përfshirjen e stafit, studentëve dhe partnerëve me të cilët institucioni bashkëpunon.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete përnjësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e NJSBC dhe përbërjen e saj, rezulton se janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve. Bazuar në takimin e zhvilluar me përfaqësues të njësive përkatëse, studentë dhe personel akademik rezulton se ndiqen veprimtaritë që lidhen me evidentimin e problematikave, vlerësimin periodik të cilësisë, marrjen e masave në kuadër të përmirësimit, marrja e mendimit të studentëve, vlerësim të performancës së stafit, përshtatje të metodologjive të ndryshme dhe zbatimi i eksperiencave ndërkombëtare në FSHM etj.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programit të studimit. Njësia Bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Në nivel Departamenti dhe Institucional, njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë.</p>

P. P. P. *P. P. P.*

<p>administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e secilit prej anëtareve të NJSBC janë të përcaktuara qartë në rregulloret e AU dhe rregulloren e funksionimit të zyrës.</p> <p>Përfshirja e stafit dhe studentëve në procese të ndryshme të cilësisë, u deklarua në takimet e realizuara me ta. Kjo mundëson transparencën dhe informimin në lidhje me proceset që kryhen. Partnerët dhe bashkëpunëtorët, janë të përfshirë në evente të ndryshme të organizuara nga fakulteti kryesisht në organizim eventesh dhe veprimtari kërkimore e shkencore. (Evidenca 1.24 a)</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, përfshihen bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin. Referuar marrëveshjeve që AU ka me insitucione të tjera të arsimit të lartë dhe takimit që GVJ realizoi me Dekanin dhe NJSBC, rezulton se çdo procedurë që kryhet kalon nëpërmjet njoftimit paraprak dhe me pas kalon në proces zhvillimi. Në këto procese vazhdimisht përfshihen bashkëpunëtorë, partnerë të FSHM ose të AU dhe studentë të diplomuar, të cilët ndihen pjesë integrale e çdo procesi me rëndësi në fakultet.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë

Paulina *DeLuca*

krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me studentët dhe Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti, rezultoi se, dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë në AU janë bërë publike. Studentët, stafi akademik dhe të gjithë të interesuarit mund të kenë akses në këtë dokumentacion dhe mund të marrin informacionin e duhur mbi proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ku janë të prezantuara edhe informacionet rreth projekteve të fituara apo edhe projekteve në proces e sipër që presin përgjigje. (Raport-vjetor-v.a-2020-2021-pdf.pdf (albanianuniversity.edu.al))</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Referuar Kodit të Etikës rezultoi se AU, tregon kujdes në publikimin e informacioneve apo të dhënave personale që mund të prekin stafin akademik, administrativ apo studentët. GVJ identifikoi se rezultatet e vlerësimeve, raportet dhe analizat publikohen, duke respektuar lirinë akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. Konstatohet gjithashtu se raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në raportet vjetore të institucionit dhe planin strategjik, rezultoi se AU adreson në planin strategjik të institucionit dhe në planin vjetor të punës gjetjet dhe dobësitë e nxjerra nga vlerësimi i brendshëm të programit të studimit, të cilat duhen përmirësuar. P.sh evidentimi i problematikës lidhur me infrastrukturën e personave me aftësi të kufizuara është evidentuar nga ana e institucionit dhe është adresuar për zgjidhje.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se përveç informimit dhe publikimit të rezultateve që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, një aspekt mjaft i rëndësishëm është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet repsektive. Nëse këto gjetje kanë impakt në organizimin e institucionit dhe prekin aspekte të rëndësishme të funksionimit të tij, ato diskutohen në Senatin Akademik. Në rastet kur gjetjet kanë impakt financiar ato adresohen për vlerësim dhe vendimmarrje në Bordin e Administrimit. GVJ evidenton se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive të zhvilluara në përmbushje të cilësisë në nivelin institucional dhe të programeve të studimit</p>
---	--

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se AU e ka në fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve në kuadër të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë për programin e studimit.</p>
--	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

P. P. P. P.
P. P. P. P.

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Stomatologji”

a. Pika të forta dhe afirmime:


1. Programi i studimit është një program bashkëkohor studimi i një cilësie të lartë, i hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, në të cilin paraqitet një koordinim i mirë i teorisë me praktikën;
2. Literatura e programit të studimit është bashkëkohore, e pasur si në literaturën e detyrueshme ashtu edhe në atë të rekomanduar, e cila shërben si bazë e formimit teorik të studentit dhe për aplikim praktik në punime në pacientë;
3. Funkcionaliteti i sallave për praktikë klinike, që mundëson njohuritë teorike dhe klinike;
4. Fakulteti garanton burimet njerëzore, dhe aspektin cilësor të Programit;
5. Numri i njësive laboratorike, dhomat mësimore, bibliotekat mundësojnë performancën optimale, të programit të studimit të stomatologjisë;
6. Programi i studimit ofrohet në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, me aktet ligjore në fuqi si dhe me aktet normative të Insitucionit;

b. Pika të dobëta:

1. Numër i ulët i publikimeve shkencore në Platforma prestigjioze, si: Web of Science, Scopus, Pubmed, linqet e tre publikimeve të vendosura në raport; (*Standardi V.6, kriteri 4*)
2. Numër i ulët i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare, përkundrejt numrit të lartë të MoU; (*Standardi II.6, kriteri 4*)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që stafi akademik e studentët të shtyhen e të motivohen që rastet e punuara në klinikë të publikohen në revista ndërkombëtare të platformave prestigjioze, si: Web of Science, Scopus, Pubmed;
2. GVJ rekomandon që MoU e paraqitura me Institucionet partnere të funksionalizohen, me qëllim që programi të përditësohet, përshtatet dhe të riorganizohet edhe më tej;
3. GVJ rekomandon që nga 300 kredite që janë të planifikuara në ciklin e studimeve të Programit Msc i Integruar në Stomatologji, të rezervohen së paku 15 kredite për realizimin e temës së diplomës duke i dhënë një rëndësi të vecantë implikimit klinik për realizimin e hulumtimeve kërkimore shkencore;



4. Disa nga linqet/adresat e dhëna në RVB lidhur me vlerësimin e programit, nuk ishin të aksesueshme. Andaj, GVJ rekomandon që në të ardhmen ti kushtohet vëmendje e veçantë web faqes, si njëra ndër burimet kryesore të aktiviteteve, të cilat zhvillohen brenda Programit, gjegjësisht Fakultetit;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle of Master of Science in “Dentistry”

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is a contemporary study program of a high quality, designed in accordance with the needs of the labor market, presented in a good coordination of theory and practice;
2. The literature of the study program is contemporary, rich in both mandatory and recommended literature, which serves as the basis of the student’s theoretical training and practical application in work with patients;
3. The functionality of the labs for clinical practice, which enables theoretical and clinical knowledge;
4. The faculty guarantees human resources and the qualitative aspect of the study program;
5. The number of lab units, classrooms and libraries enable the optimal performance of the dentistry study program;
6. The study program is offered in accordance with the State Quality Standards, with the legal acts in force, as well with the normative acts of the Institution;

b. Weaknesses:

1. Low number of scientific publications on prestigious platforms, such as: Web of Science, Scopus, Pubmed, the links of the three publications placed in the report; (*Standardi V.6, kriteri 4*)
2. Low number of joint international projects, against the high number of MoUs; (*Standardi II.6, kriteri 4*)



Recommendation:

1. Experts recommend that the academic staff and students be pushed and motivated to publish the cases worked in the clinic in international journals of prestigious platforms, such as: Web of Science, Scopus, Pubmed;
2. The experts recommend that the MoU presented with the partner institutions be operationalized, in order for the program to be updated, adapted and reorganized even further;
3. Experts recommend that out of the 300 credits that are planned in the study cycle of the Integrated Msc Program in Dentistry, reserve at least 15 ECTS for the realization of the subject of the diploma, giving special importance to the clinical implication for the realization of scientific research;
4. Some of the links/addresses given in RVB related to the evaluation of the program were not accessible; (see Report: Standard I.3, criterion 8; Standard II.3, criterion 5; Standard II.6, criterion 3;). Therefore, expert team recommends that special attention should be paid in the future in web page of the AU, as one of the main sources of activities, which take place within the Program, respectively within the Faculty;

P. P. P. P.
P. P. P. P.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT					X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT					X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT					X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE					X
VLERËSIMI TËRËSOR					X

P. P. P. P.